Raport mbi të drejtat e njeriut në Kosovë 2010

Zyra për demokraci, të drejta të njeriut dhe punë

Raportet e shtetit mbi praktikat e të drejtave të njeriut – 2010

8 prill 2011

Kosova është demokraci parlamentare me rreth 2.2 milionë banorë. Zgjedhjet shumëpartiake të 12 dhjetorit për Kuvend dhe legjislatura kombëtare në përgjithësi i përmbushën standardet ndërkombëtare, por parregullsitë serioze në disa zona rezultuan në rivotime të kufizuara në disa komuna. Vendi e shpalli pavarësinë në vitin 2008, kur e pranoi planin e Ahtisarit, i cili parashikonte mekanizma të sponsorizuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX), për ta mbështetur Qeverinë e re. Forcat e sigurisë u raportonin autoriteteve civile gjersa monitoroheshin nga forca paqeruajtëse për Kosovën (KFOR), e autorizuar nga OKB-ja, dhe e udhëhequr nga NATO-ja.

Në problemet dhe abuzimet që u raportuan gjatë këtij viti përfshihen: ndërhyrja e Qeverisë në forca të sigurisë dhe gjyqësi; paraburgimi i gjatë dhe mungesa e procesit të drejtë gjyqësor; kërcënimi ndaj mediave nga zyrtarët publikë dhe individët; incidentet e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve fetare dhe dëmtimi i pronave fetare; përparimi i kufizuar në kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) në shtëpitë e tyre; korrupsioni në Qeverisë, duke përfshirë korrupsionin në forcën policore dhe në gjyqësi; dhuna dhe diskriminimi i femrave; trafikimi i personave, posaçërisht i vajzave dhe i grave për shfrytëzim seksual; dhuna shoqërore, abuzimi dhe diskriminimi i komuniteteve pakicë; diskriminimi shoqëror i personave me aftësi të kufizuara; abuzimi dhe diskriminimi i personave në bazë të orientimit të tyre seksual; dhe puna e fëmijës në sektorin joformal.

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Seksioni 1 Respektimi i integritetit të personit, përfshirë këtu lirinë nga:

a. Privimi arbitrar ose i paligjshëm i jetës

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme gjatë këtij viti. Pati zhvillime në rastet e viteve 1999-2003 të vrasjeve të dyshuara me motive politike.

Pas publikimit të një video rrëfimi në nëntor të vitit 2009 të një vrasësi politik të vetëshpallur, Nazim Bllaca, EULEX-i arrestoi katër persona gjatë këtij viti nën dyshimin se kishin kryer mbi 20 vrasje me motive politike gjatë periudhës 1999-2003. Bllaca dhe tre personat e tjerë të arrestuar për këtë rast dyshohen për vrasje dhe tentimvrasje të personaliteteve politike me urdhra të Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK), që i shërbeu Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) deri në fund të konfliktit të Kosovës. SHIK-u raportoi shpërndarjen e vet zyrtare në vitin 2008. Hetimet lidhur me këtë rast vazhduan deri në fund të vitit. Më 13

korrik, policia e EULEX-it e arrestoi Fahredin Gashin në lidhje me këtë hetim. Gashi akuzohej për krime luftë të kryera në vitin 1999 në komunën e Lipjanit. Më 30 nëntor, Nazim Bllaca u lirua nga paraburgimi pasi kishte kaluar një vit në arrest. Lirimi u urdhërua sipas ligjit, pasi paraburgimi nuk mund të jetë më i gjatë se një vit.

Mandati i EULEX-it përfshinte hetimin, gjykimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës nga konflikti i vitit 1998-99 (shih pjesën 1.e., procedurat e gjykimit).

Më 5 korrik, një sulmues i panjohur shtiu dhe plagosi Petar Milletiqin, anëtar i Kuvendit dhe sekretar i përhershëm i Partisë së Pavarur Liberale Serbe në Kosovë, para banesës së tij, gjersa po nisej për në punë. Ministri i Brendshëm, Bajram Rexhepi, u tha mediave se Milletiq ishte qëlluar me dy plumba. Milletiq u trajtua në spital dhe u lirua pas një javë. Policia tha që kishin përshkrimin e gjuajtësit, dhe hetimet vazhduan deri në fund të vitit.

Më 12 dhjetor, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KE) publikoi një raport të raportuesit të KE-së, Dick Marty, mbi pretendimet lidhur me trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në vend. Raporti theksoi se prej korrikut të vitit 1999 deri nga mesi i vitit 2000, elementë të UÇK-së dhe bashkëpunëtorë mbanin dhjetëra persona "të zhdukur" në Shqipëri në lokacione të caktuara joformale në Bicaq, Burrel, Rripe, dhe Fushë-Krujë. Raporti më tej pohon që një numër i vogël i këtyre personave u bënë "viktima të krimit të organizuar", veshkat e tyre ishin hequr për t'u përdorur nga një rrjet ndërkombëtar për trafikim të organeve. Raporti theksoi se të gjithë personat e ndaluar, shqiptarët dhe serbët, supozohej të ishin vrarë. Sipas raportit, burime të drejtpërdrejta implikonin pesë anëtarë të të ashtuquajturit "Grupi i Drenicës", në kuadër të UÇK-së -- Hashim Thaçin, Xhavit Halitin, Kadri Veselin, Azem Sylën, dhe Fatmir Limajn -- të cilët urdhëruan, dhe në disa raste personalisht i mbikëqyrën, vrasjet, ndalimet, rrahjet dhe marrjet në pyetje në kontekst të operacioneve të udhëhequra nga UÇK-ja në territorin e Shqipërisë ndërmjet vitit 1998 dhe 2000. Raporti gjithashtu theksoi se kryesuesi i të ashtuquajturit Grupi i Drenicës, Kryeministri aktual Hashim Thaçi, thuhej se ka vepruar me "mbështetjen dhe bashkëfajësinë" jo vetëm të strukturës qeverisëse zyrtare të Shqipërisë, duke përfshirë qeverinë socialiste shqiptare në pushtet në atë kohë, por edhe të Shërbimit Sekret të Shqipërisë dhe të mafies shqiptare.

Misioni i administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK) dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), mandatet e të cilëve nuk shtriheshin në Shqipëri, kishin hetuar më parë pretendimet për nxjerrje të organeve, që përfshiheshin në raportin e Martit, dhe konkluduan që nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për të ngritur rast penal. Njësia e EULEX-it për krime të luftës mban një hetim të hapur lidhur me pretendimet për trafikim të organeve. Njësia e EULEX-it për krime të luftës theksoi se nuk posedonte kurrfarë dëshmie lidhur me pretendimet në raportin e Martit dhe i bëri thirrje KE-së dhe palëve të tjera të ndajnë çfarëdo dëshmie që mund të kenë marrë. Raporti gjithashtu u bën thirrje Serbisë, Kosovës dhe Shqipërisë të bashkëpunojnë ngushtë me EULEX-in për t'i mbështetur hetimet. Autoritetet kosovare e dënuan përmbajtjen e raportit, por premtuan bashkëpunimin e tyre me hetimet.

Më 11 qershor, Gjykata e Qarkut e Prishtinës e dënoi Arben Berishën me dënimin më të lartë me burg prej 40 vjetësh për vrasjen në vitin 2007 të policit Triumf Riza. Kjo Gjykatë e dënoi edhe Fitm Avdiun me 10 vjet burg si bashkëfajtor dhe e gjobiti Agron Eminin me 2,000 euro ($2,680) pasi i kishte ndihmuar kryesit të veprës penale. Tre personat e tjerë të akuzuar për këtë rast -- Enver Sekiraça, Ilir Abdullahu dhe Rrahim Abdullahu -- mbetën në liri.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje me motive politike; megjithatë, sipas Komitetit ndërkombëtar të kryqit të kuq (ICRC), në fund të gushtit, 1,882 persona ende gjendeshin në listën e personave të zhdukur që nga konflikti i vitit 1998-99. Prej personave të zhdukur, 70 për qind ishin shqiptarë të Kosovës dhe 30 për qind ishin serbë të Kosovës dhe pakica të tjera.

Gjatë këtij viti, Ministria e Drejtësisë dhe ish-Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML), që u bë Departament për Mjekësi Ligjore (DML), këtë vit, në pajtim me ligjin, vazhduan identifikimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur. Prej janarit deri në dhjetor, DML dhe Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur (KNPZH) pozitivisht identifikuan 56 persona të zhdukur dhe ua transferuan mbetjet mortore familjeve të tyre. Përveç kësaj, DML dhe KNPZH konfirmuan identitetin e 47 personave të identifikuar dhe të varrosur më parë, por për të cilët kishte brenga për identifikimin fillestar. Në gusht, DML, me ndihmën e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), filloi zhvarrosjen në një vend të madh, të ndërlikuar në komunën e Vushtrrisë. Që nga mesi i dhjetorit, 364 grupe të mbetjeve mortore të identifikuara mbetën nën kujdesin e DML-së (337 nga varrezat në Kosovë dhe 27 nga varrezat në Serbi).

Gjatë këtij viti, zyrtarë nga Kosova dhe Serbia u takuan katër herë në një grup punues për persona të zhdukur të kryesuar nga ICRC-ja dhe nën mbikëqyrjen e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Dy takime të nëngrupeve të tyre për çështje të mjekësisë ligjore u mbajtën gjatë këtij viti.

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë praktika të tilla, dhe nuk pati raportime që Qeveria, EULEX-i apo KFOR-i (që ka autoritet të kufizuar për arrestim dhe ndalim) i zbatuan ato gjatë këtij viti

Raporti i 12 dhjetorit i KE-së për trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore (shih Seksionin 1.a.) pohoi se prej vitit 1998 deri në qershor të vitit 1999, UÇK-ja, me bashkëpunim të Shërbimit Sekret të Shqipërisë, ndaloi "të burgosurit e luftës" nga Kosova në lokacione në Durrës, Cahan dhe Kukës, ku mbaheshin në qeli të improvizuara e të pista, pa ujë, pa ushqim, dhe herë pas here vizitoheshin nga ushtarët e UÇK-së për t'u marrë në pyetje në mënyrë të egër apo për t'u rrahur pa hesap.

Disa përkrahës të udhëheqësit të Lëvizjes "Vetëvendosje", Albin Kurti, raportuan se ishin lënduar gjatë arrestimit të tij më 12 qershor në Prishtinë. Kurti, i cili iku nga arresti shtëpiak, që i ishte shqiptuar për shkak të protestave të dhunshme të vitit 2007 dhe iu shmang disa përpjekjeve për ta kthyer atë nën kujdes, u arrestua pas një proteste të mbajtur në selinë e grupit të tij. Mbi 100 përkrahës u përpoqën ta pengonin arrestimin dhe Policia e Kosovës (PK) përdori dy bomba me gaz lotsjellës për ta kontrolluar masën. Disa përkrahës kërkuan trajtim mjekësor pas ndërveprimit me policinë, duke pohuar që ishin rrahur me shkopinj dhe kishin fituar djegie nga lotsjellësi. Aktivistët e Vetëvendosjes i përmbytën dy vetura të EULEX-it që ishin të pranishme në vendin e ngjarjes dhe ua prenë gomat disa veturave të PK-së.

Në vitin 2009, Komiteti i KE-së për Parandalimin e Torturës (KPT) publikoi një raport për këtë vend duke u bazuar në vizitat e veta në vitin 2007. Raporti thoshte që KPT-ja pranoi disa

raporte për keqtrajtim të të ndaluarve nga policët e PK-së, kryesisht me grushte, shuplaka, dhe shqelma nga policët që përpiqeshin të nxirrnin rrëfim nga ta. Raporti vuri në pah që në disa raste, keqtrajtimi i supozuar (si ekzekutimi i simuluar dhe rrahjet e vazhdueshme e të ashpra) lehtë mund të përshkruheshin si torturë dhe theksoi se një numër i personave të ndaluar pohonin që policët kishin ushtruar presion psikologjik në ta për të mos ushtruar ankesë lidhur me keqtrajtimin.

Kushtet e burgjeve dhe të qendrave të ndalimit

Burgjet dhe qendrat e ndalimit në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare, dhe Qeveria u lejoi vizita monitoruese vëzhguesve të pavarur për të drejta të njeriut.

Pati disa pohime për abuzim dhe keqtrajtim të të burgosurve gjatë këtij viti. Në tetor, Qendra e Kosovës për rehabilitimin e viktimave të torturës (QKRVT), një OJQ vendëse që i vizitonte dhe monitoronte burgjet dhe qendrat e ndalimit, publikoi një raport për vizitat e bëra gjatë vitit 2009-10 në të gjitha burgjet dhe qendrat e ndalimit në vend. QKRVT nuk raportoi për pohime për përdorim të tepër të forcës; ajo pranoi disa pohime për keqtrajtim nga policia, kryesisht gjatë arrestimit apo marrjes në pyetje, dhe asnjë rast të keqtrajtimit gjatë mbajtjes në polici.

QKRVT raportoi një pohim për përdorim të tepërt të forcës nga një rojë në qendrën e ndalimit të Pejë, por theksoi se i burgosuri nuk raportoi asnjë abuzim kundër tij kur ishte intervistuar përsëri në prill. Përveç kësaj, QKRVT raportoi për një rast të abuzimit fizik të një të mituri në qendrën korrektuese në Lipjan në shkurt të vitit 2009.

QKRVT vuri në pah që disa qelive, kryesisht në burgun e Dubravës, u mungonte ventilimi i mirëfilltë dhe qasja në dritën natyrore. Cilësia dhe sasia e produkteve higjienike që u jepej të burgosurve ishte e vogël. QKRVT gjithashtu ngriti brenga për mbingarkesë në burgun e Dubravës. QKRVT i lavdëroi nismat e reja për t'i kontrolluar të burgosurit për HIV dhe hepatit, dhe përmendi themelimin e Institutit për psikiatri mjekoligjore, të themeluar me financim dhe asistencë të BE-së, për trajtimin e të burgosurve të sëmurë mendërisht. Megjithatë, QKRVT ngriti shqetësime që furnizimi me barëra në qendra të ndalimit dhe korrektimit nganjëherë ndërpritej dhe tregoi se rënia në investime për furnizim me barëra, shërbime dhe trajtim të specializuar shëndetësor ndikonte në cilësinë e kujdesit shëndetësor në sistemin korrektues.

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) i udhëhoqi punët ditore në të gjitha qendrat korrektuese dhe të ndalimit. EULEX-i mbajti rol të kufizuar monitorues, mentorues dhe këshillues në burgje. Përveç kësaj, EULEX-i i transportonte të burgosurit sipas kërkesës. Në fund të dhjetorit, rreth 1,320 të burgosur të dënuar dhe 130 të paraburgosur ishin të përzier në burgje dhe qendra të ndalimit. Në burgje dhe qendra të ndalimit ishin edhe 35 femra (20 të burgosura të dënuara dhe 15 të paraburgosura), dhe 45 të mitur (12 të ndaluar dhe 33 në burg për të mitur). Gjatë këtij viti, Burgu i Dubravës kishte mesatarisht 650 deri në 1,000 të burgosur në muaj, nën kapacitetin e vet të plotë prej 1,200 të burgosurve. Tri qendra korrektuese gjashtë qendra të ndalimit, dhe një qendër për mbrojtje të dëshmitarëve, dhe një spital i burgut punuan gjatë këtij viti.

QKRVT raportoi se pati burgje dhe qendra të ndalimit në të cilat të paraburgosurit përziheshin me të burgosurit e dënuar, duke përfshirë qendrat në Pejë, Gjilan dhe Mitrovicë veriore. Shërbimi Korrektues i Kosovës raportoi se nuk kishte asnjë objekt në të cilin

vendoseshin së bashku të paraburgosurit me të burgosurit e dënuar. QKRVT gjithashtu raportoi se kishte vëzhguar raste të shumta të të paraburgosurve që mbaheshin për më tepër se 12 muaj. Shërbimi Korrektues konfirmoi se një numër i të paraburgosurve mbaheshin për periudha kohore më të gjata se një vit, që është shkelje e ligjit.

QKRVT raportoi se "nuk ka probleme të mëdha lidhur me kontaktin e të burgosurve me botën e jashtme, qasjen në informata, apo të drejtën për ta ushtruar fenë", që të burgosurve u ofroheshin informata adekuate për të drejtat e tyre dhe ushqimin e tyre, dhe se "shumica e të drejtave në qendrat e ndalimit ende respektohen mirë". QKRVT gjithashtu ngriti brengën për mungesë të mësimdhënësve për të mitur në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe theksoi se disa lëndë që mësoheshin në sistemin e shkollimit publik nuk mësohen në qendrën korrektuese. Korrupsioni dhe nepotizmi, posaçërisht në Burgun e Dubravës, mbetën brengë. Si pasojë, privilegjet, masat disiplinore dhe shqyrtimi i ankesave nuk zbatoheshin gjithmonë në mënyrë të drejtë e transparente.

Autoritetet lejuan vizita dhe monitorim të burgjeve dhe qendrave të ndalimit. Avokati i Popullit dhe QKRVT-ja i inspektuan qendrat korrektuese dhe qendrat e ndalimit gjatë këtij viti. Avokati i Popullit raportoi për bashkëpunim të mirë nga shërbimi korrektues, duke përfshirë mundësinë për të mbajtur intervista private me të burgosur gjatë vizitave. Të ndaluarit mund të ushtronin ankesa dhe kërkesa për hetime pranë organeve gjyqësore, pa censurim, përmes kutive anonime në burg. Drejtori i SHKK-së pranoi 65 kërkesa zyrtare nga të burgosurit lidhur me kushtet në burgje deri në fund të vitit, por asnjëra prej tyre nuk ishte klasifikuar si ankesë nga SHKK-ja. Prej 8 – 15 qershor, KPT-ja vizitoi disa qendra të ndalimit dhe qendra korrektuese; KPT-ja nuk publikoi asnjë raport për këto vizita deri në fund të vitit. ICRC-ja nuk kreu asnjë inspektim të burgjeve apo të qendrave të ndalimit gjatë këtij viti.

Raporti i QKRVT-së i quante kushtet materiale "në përgjithësi të mira" dhe tregoi për një sërë përmirësimesh që nga viti 2008 në bazë të rekomandimeve të vëzhguesve. "Qelitë e ndalimit në polici janë duke u rinovuar dhe situata vazhdon të përmirësohet në nivel të infrastrukturës. Kushtet në ndalim policor janë në përgjithësi të mira dhe ligji në përgjithësi respektohej". Qeveria shpenzoi 3.39 milionë euro ($4.5 milionë) gjatë këtij viti për t'i përmirësuar kushtet e jetesës në burgje dhe qendra të ndalimit dhe për ta hapur një qendër të re të ndalimit, me kapacitet për 200 persona, në Smerkonicë.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

Roli i policisë dhe i aparatit të sigurisë

Forcat vendëse të sigurisë përfshinin PK-në dhe FSK-në. Policia funksionon nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në vitin 2008, Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit, EULEX, u bë funksional dhe themeloi mandatin e vet për t'i monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet lokale të gjyqësisë dhe të zbatimit të ligjit. EULEX-i posedon autoritet të kufizuar ekzekutiv në fushat që përfshijnë krimin e organizuar, korrupsionin, krimet e luftës, mbrojtjen e dëshmitarëve, shpëlarjen e parave, financimin e terroristëve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Në korrik të vitit 2009, policia mori përgjegjësinë primare për hetimin e terrorizmit që nuk kishte ndikim ndërkombëtar. FSK-ja është forcë e

sigurisë dhe mbrojtjes civile, me armatim të lehtë, që funksionon nën autoritetin civil të Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe mentorohet nga KFOR-i.

Në prill, Kryeministri emëroi një ushtrues të ri të detyrës së drejtorit të përgjithshëm të PK-së. Ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i ri i përgjithshëm më pas nënshkruan një urdhër për krijimin e një zinxhiri të unifikuar të komandimit brenda policisë. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm, me mbështetjen e ministrit të Punëve të Brendshme, e formalizoi një strukturë organizative për polici.

Që nga dhjetori, anëtarët e pakicave etnike përbënin rreth 15 për qind të 7, 291 policëve; 9.5 për qind e policëve ishin serbë të Kosovës. Rreth 13 për qind e policëve ishin femra.

Qeveria dhe EULEX-i ndanin autoritetin ekzekutiv mbi forcën policore, ndonëse autoriteti i EULEX-it është i kufizuar për zonat me shumicë serbe në veri të lumit Ibër. PK ishte përgjegjëse për operacionet ditore policore në të gjitha rajonet e vendit, por EULEX-i ushtronte autoritet shtesë ekzekutiv dhe mbikëqyrje në komunat veriore me shumicë serbe të Zubin Potokut, Zveçanit, Leposaviqit dhe në pjesën veriore të Mitrovicës.

Njësitë e specializuara policore që hetojnë krimet e luftës, krimin financiar dhe krimin e organizuar, dhe programi i policisë së EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve, mbetën të plotësuara me policë ndërkombëtarë të EULEX-it dhe vepronin në mënyrë të pavarur nga policia. EULEX-i dhe PK-ja bashkërisht drejtonin njësitë për zbulim penal dhe krim të organizuar. Policët, prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it, të stacionuar në vend, kanë diskrecion të gjerë për të intervenuar në cilëndo çështje të veçantë penale. Megjithatë, si çështje praktike, shumica e detyrave dhe përgjegjësive policore ishin në duar të policisë vendëse.

Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK) vepronte si organ i pavarur nën Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ka për detyrë të kryejë hetime dhe inspektime në të cilat përfshihet personeli i policisë. Ligji për IPK-në u ndryshua më 14 tetor dhe do të hyjë në fuqi më 1 qershor 2011, duke transferuar autoritetin për kryerjen e hetimeve penale të personelit të policisë prej PK-së tek IPK-ja e pavarur.

Gjatë këtij viti, IPK-ja shqyrtoi 1,185 ankesa, 577 e tyre ishin ankesa të iniciuara nga qytetarët, 13 ishin ankesa nga institucionet, 595 ishin të iniciuara nga policia. Prej atyre ankesave, IPK-ja vazhdoi hetimet e mëtejme për 408 raste dhe 541 raste ia dorëzoi Njësisë së PK-së për Standarde Profesionale (NJSP). Vendimet gjyqësore pritej të merreshin për 106 raste, dhe 100 pritej të zgjidheshin në Komisionin për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici. Prej 408 rasteve të hetuara nga IPK-ja, 20 për qind ishin pohime për shkelje të rënda disiplinore. Prej këtyre shkeljeve disiplinore, 20 për qind ishin për raste të rënda të sjelljes së pavend të policëve, 13 për qind përfshinin pohimet për përdorim të pavend të forcës, 12 për qind përfshinin veprat penale (dhe iu referuan zyrës së prokurorit), 9 për qind ishin për mosbindje, 2 për qind kishin të bënin me ankesa për korrupsion, dhe të tjerat ishin shkelje të ndryshme të kategorizuara si të rënda.

NJSP hetoi kundërvajtjet e vogla të policëve dhe imponoi ndëshkime administrative për kundërvajtje. Gjatë këtij viti, njësia hapi 639 raste, duke përfshirë rastet e mosbindjes së vogël dhe dëmtimit apo humbjes së pronës policore. Që nga fundi i vitit, 73 raste mbetën në hetim e sipër.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi gjatë ndalimit

Policia në përgjithësi arrestimet i bënte haptas duke përdorur urdhër arrestin e lëshuar nga gjykatësi apo prokurori dhe në bazë të provave të mjaftueshme. Në disa raste, arrestimet kryheshin nga policët e maskuar apo sekretë. Sipas ligjit, arrestimet duhet të bazohen në urdhrat e prokurorit, dhe të arrestuarit duhet të sillen para gjykatësit brenda 72 orëve. Shumica e arrestimeve të këtij viti u bënë nga policia. Nuk pati raportime që policia e abuzoi rregullin 72-orësh, dhe autoritetet në përgjithësi i akuzonin të arrestuarit brenda gjashtë-tetë orëve apo i lironin. Të arrestuarit kanë të drejtë të informohen, në gjuhën që e kuptojnë, për shkakun e arrestimit të tyre; të heshtin dhe të mos u përgjigjen pyetjeve, përveç pyetjeve për identitetin e tyre; për ndihmë falas të përkthyesit; për avokat mbrojtës dhe për sigurim të avokatit mbrojtës nëse nuk mund ta paguajnë; për trajtim mjekësor dhe psikiatrik; dhe për ta informuar ndonjë anëtar të familjes. PK-ja dhe policia e EULEX-it në përgjithësi i respektuan shumicën e këtyre të drejtave në praktikë.

Në raportin e vet për vitin 2009, KPT theksoi se një numër i personave të ndaluar pohonin që nuk ishin në gjendje të kontaktonin me avokat në fillim të ndalimit të tyre, por vetëm në kohën e periudhës fillestare të marrjes së tyre në pyetje nga policët penalë. Në disa raste, e drejta për qasje në avokat u bë efikase vetëm pas periudhës fillestare të marrjes në pyetje

Nën rrethana të jashtëzakonshme, KFOR-i mund t'i arrestojë dhe ndalojë individët pa urdhër arrest. Komandanti i KFOR-it mund t'i ndalojë individët për 72 orë, dhe ta vazhdojë atë edhe për 72 orë të tjera. Pas 144 orësh, KFOR-i duhet ta lirojë të ndaluarin. Nuk pati raportime që KFOR-i kishte arrestuar persona pa urdhër arrest gjatë këtij viti.

PK-ja dhe Policia e EULEX-ut mund t'i mbajnë individët deri në 72 orë pa urdhër të gjykatës. Pas një vendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga dita e arrestimit, dhe mund ta vazhdojë ndalimin deri në gjithsej një vit nëse nuk është ngritur asnjë aktakuzë. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të procedurës gjyqësore, paraburgimi mund të urdhërohet apo të ndërpritet vetëm me vendim të trupit gjykues. Ekziston një sistem funksional mbi dorëzaninë. Ligji lejon arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzanisë si alternativa ndaj paraburgimit. Të pandehurit gjithashtu mund të ankohen për paraburgimin e tyre

Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji parashikon që gjykatësi mund ta shqiptojë masën e paraburgimit vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe që personi ka të ngjarë t'i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë dëshmitë; të ndikojë në dëshmitarë; të ikën; ta përsërisë veprën penale apo të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; apo kur masat e tjera të parapara me ligj nuk mjaftojnë për ta siguruar praninë e të pandehurit në procedurën penale. Megjithatë, në praktikë, gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa treguar justifikim të mbështetur në prova. Në veçanti, në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, me seli në Vushtrri, paraburgimi për të pandehur është vazhduar pandërprerë gjatë tërë kohës që gjykata punonte me kapacitet të kufizuar.

Shtyrjet e gjykimeve shkaktoheshin nga faktorë që përfshinin joefikasitetin dhe korrupsionin e gjyqësorit.

Falja

Më 17 shkurt, Presidenti fali apo ua zbuti dënimet 62 individëve (rreth 5 për qind e numrit të përgjithshëm të të burgosurve dhe të paraburgosurve) për nder të përvjetorit të dytë të pavarësisë së vendit.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjyqësi të pavarur; megjithatë, gjyqësia vendëse nganjëherë ishte e njëanshme, i nënshtrohej ndikimit të jashtëm dhe nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Pati raportime të besueshme për korrupsion brenda gjyqësisë vendëse, dhe sistemi i gjykatave ishte joefikas. Nuk kishte mekanizëm efikas për procedura disiplinore kundër gjykatësve

Sistemi i gjykatave përfshinte një gjykatë kushtetuese, një gjykatë supreme, pesë gjykata të qarkut, një gjykatë ekonomike, 25 gjykata komunale, 25 gjykata për kundërvajtje, dhe një gjykatë të apelit për kundërvajtje. Më 22 korrik, Kuvendi miratoi Ligjin për Gjykatat, i cili rregullon organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave në vend. Përmes EULEX-it, 31 gjykatës ndërkombëtarë dhe 15 prokurorë ndërkombëtarë i mbështetnin gjykatësit dhe prokurorët vendës. Vendi ka një prokurori publike të shtetit, pesë prokurori të qarkut dhe shtatë prokurori komunale. EULEX-i ushtroi autoritetin e vet ekzekutiv mbi një prokurori speciale, që përfshinte tetë prokurorë ndërkombëtarë të përqendruar në krime të rënda, duke përfshirë trafikimin e personave, shpëlarjen e parave, krimet e luftës dhe terrorizmin.

Në rastet penale, në të cilat gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it ushtronin juridiksionin e vet, këta gjykatës shërbenin në kolegje të përziera me gjykatës vendës. Gjykatësit e EULEX-it përbënin shumicën në këto kolegje, me një gjykatës të EULEX-it që shërbente si kryesues i kolegjit. Kryetari i Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it ka kompetencë të vendosë që kolegji të ketë përbërje të plotë apo shumicë të gjykatësve vendës, apo të mos u caktojë faza të posaçme të procedurës penale gjykatësve të EULEX-it. Për rastet civile në të cilat gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it e ushtronin juridiksionin e tyre, kolegjet gjyqësore përbëheshin prej tre gjykatësve, dy prej të cilëve ishin gjykatës të EULEX-it.

Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), ishte përgjegjëse për hetimin e veprimtarive të gjykatësve, prokurorëve dhe gjykatësve porotë, dhe për ndjekjen penale të rasteve të sjelljes së keqe para KGJK-së. 89 raste të reja iu paraqitën ZPD-së gjatë këtij viti. ZPD-ja mbajti seanca dëgjimore dhe vendosi në 23 prej 219 rasteve që gjendeshin para saj. Në numrin e përgjithshëm të lëndëve të ZPD-së përfshiheshin edhe 130 raste të bartura nga vitet e mëparshme. Njësia e Auditimit Gjyqësor analizoi dhe vlerësoi punën e gjykatave dhe të prokurorive publike dhe i dorëzoi raporte dhe rekomandime KGJK-së.

Gjykata e Qarkut e Mitrovicës vazhdoi të funksiononte pjesërisht gjatë këtij viti. Që nga viti 2008, vetëm gjykatësit e EULEX-it ishin të vendosur në ndërtesën e gjykatës në Mitrovicën veriore, ndërsa punët e tjera të Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale të Mitrovicës, të Prokurorisë së Qarkut dhe të Prokurorisë Komunale të Mitrovicës vazhduan të kryheshin në Gjykatën Komunale në Vushtrri.

Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Komunale në Mitrovicë dhe gjykatat komunale në Leposaviq e Zubin Potok mbetën të mbyllura pas protestave të vitit 2008 kundër pavarësisë së vendit. Përpjekjet për ta rihapur Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë ngelën në baltë në korrik kur gjykatësit serbë të Kosovës, të caktuar për t'i zënë postet në gjykata, u tërhoqën pas kërcënimit nga autoritetet paralele serbe dhe personat që pohonin t'i përfaqësonin

institucionet serbe. Dy gjykatës serbë të Kosovës thanë se nuk do t'i merrnin postet derisa "kushtet përkatëse", duke përfshirë masat e sigurisë, të mos ishin në vend.

Qeveria serbe vazhdoi ta drejtonte një sistem paralel të palejuar të gjyqësisë në enklavat serbe në Kosovë dhe në komunat me shumicë serbe.

Procedurat e gjykimit

Gjykimet janë publike, dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për të qenë të pranishëm në gjykimet e veta, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin dëshmitë, dhe të kenë përfaqësim ligjor. Përfaqësimi mund të sigurohet në shpenzime publike nëse është e nevojshme; megjithatë, kjo procedurë rrallë përdorej në praktikë. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Gjykimet dëgjohen nga kolegjet e përbëra nga gjykatësit profesionalë dhe gjykatësit porotë; nuk ka gjykime me juri.

Komisioni për ndihmë juridike, një agjenci e pavarur qeveritare, u ofroi ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta përmes pesë zyrave rajonale për ndihmë juridike. Prej janarit deri në qershor, komisioni u kishte ofruar ndihmë juridike 1,479 personave.

Ministria e Drejtësisë drejtonte sektorin për integrimin e gjyqësisë, që vazhdoi t'i shqyrtonte problemet e sistemit gjyqësor që ndikonin në pakica. Për atë qëllim, Ministria drejtonte 11 zyra ndërlidhëse të gjykatave për t'u ndihmuar bashkësive pakicë në zonat e Kosovës me shumicë serbe, duke i shoqëruar anëtarët e pakicave në gjykata, duke paraqitur dokumente në gjykata në emër të tyre, dhe duke u siguruar refugjatëve dhe PZHBV-ve informata dhe ndihmë ligjore.

Rastet e krimeve të luftës mbikëqyren nga EULEX-i, i cili në vitin 2008 mori përsipër përgjegjësitë që më parë mbaheshin nga UNMIK-u, për të siguruar hetimin dhe ndjekjen e mirëfilltë të rasteve të krimeve të luftës. Nën mandatin e EULEX-it, rastet mund të hetohen dhe gjykohen vetëm nga ndërkombëtarët apo, kur është e duhur, bashkërisht me homologët kosovarë. Nga fundi i vitit 2009, prokuroria e EULEX-it kishte gjykuar katër raste të krimeve të luftës. Një raport i publikuar në maj nga Misioni i OSBE-së në Kosovë gjeti një dështim sistematik për t'i gjykuar rastet e krimeve të luftës, si dhe mungesë të burimeve për këtë përpjekje.

Më 14 dhjetor, policia e EULEX-it, e mbështetur nga PK-ja, arrestoi dy shqiptarë të Kosovës në rajonin e Prizrenit për një hetim në vazhdim e sipër për krime lufte. Akuzat kanë të bëjnë me përdorimin e masës së kërcënimit, terrorit, dëbimit dhe zhvendosjes së popullatës civile të kryer në vitin 1998 në Rahovec dhe fshatrat përreth. Hetimi kryhej nën mbikëqyrjen e një prokurori të EULEX-it nga Prokuroria Speciale e Kosovës.

Më 9 nëntor, një kolegj i përbërë nga dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjykatës kosovar e shpalli Vukomir Cvetkoviqin fajtor për krime lufte dhe e dënoi me shtatë vjet burg. Cvetkoviqi u shpall fajtor për dëbim të një familjeje nga qyteti i Klinës dhe djegien e shtëpive të dy familjeve në vitin 1999, si pjesëtar i policisë serbe.

Më 6 maj, policia e EULEX-it arrestoi pjesëtarët e ish-UÇK-së, Sabit Gecin dhe Riza Aliajn, nën dyshimin se kishin kryer krime lufte në vitin 1999. Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti dy aktakuza për këtë rast më 6 gusht. Më 25 nëntor, gjykatësi i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë konfirmoi aktakuzat kundër Sabit Gecit dhe Riza Aliajt. Të

pandehurit ngelën në paraburgim dhe gjykimi nuk ishte caktuar ende. I pandehuri i tretë është në liri.

Nuk pati zhvillime të reja që dalin nga arrestimi në shtator të vitit 2009 nga policia e EULEX-it i Sllobodan Martinoviqit, Sreçko Martinoviqit, dhe Svetllana Stojanoviqit për krime lufte të kryera në vitin 1999. Këta të tre gjoja kidnapuan dhe torturuan tetë persona në një qendër joformale të ndalimit në rajonin e Novobërdës dhe Gjilanit. EULEX-i i akuzoi për trajtim çnjerëzor, vuajtje të madhe apo cenim të integritetit trupor apo të shëndetit, përdorim të masave të kërcënimit dhe terrorit, dhe arrestim e ndalim të paligjshëm. Asnjë seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur, as data e gjykimit nuk ishte caktuar deri në fund të vitit.

Më tetor të vitit 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i shpalli Rrustem Mustafën - "Remi", Latif Gashin dhe Nazif Mehmetin fajtorë për krime lufte, torturim të civilëve të arrestuar në tri objekte ndalimi të UÇK-së. Gjykata, e përbërë nga një gjykatës vendës dhe dy gjykatës të EULEX-it, e dënoi Mustafën me katër vjet burg, Gashin me gjashtë vjet, dhe Mehmetin me tri vjet. Në fund të vitit, Mustafa mbeti në liri, në pritje të aktgjykimit të formës së prerë për ankesën e tij. Gjatë konfliktit, Mustafa kishte qenë shef i Zonës Operative të UÇK-së për rajonin e Llapit dhe më vonë u bë anëtar i Kuvendit nga radhët e PDK-së dhe kryesues i Komisionit të Kuvendit për Siguri. Që të tretë ishin arrestuar në vitin 2002 nën akuzat për krime lufte, ndalim të paligjshëm, torturim dhe vrasje të bashkëpunëtorëve të dyshuar të regjimit të Millosheviqit në vitet 1990-të. Prej 26 viktimave të shënuara në aktakuzë, një ishte serb; pesë ishin vrarë.

Nuk pati zhvillime në rastin e krimeve të luftës kundër Momçillo Jovanoviqit. Në shkurt të vitit 2009, një prokuror ndërkombëtar i EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Pejë lëshoi urdhër arrest për Jovanoviqin pasi ai dështoi t'u përgjigjej thirrjeve zyrtare për t'u paraqitur në gjykatë. Në vitit 2008, një prokuror ndërkombëtar e kishte akuzuar Jovanoviqin për krime lufte, vrasje dhe shkelje të tjera të ligjeve të luftës për incidentet që ndodhën në vitin 1998-99 në fshatin Katund i Ri.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime që Qeveria apo KFOR-i, mbanin të burgosur apo të arrestuar politikë.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Kushtetuta parashikon gjyqësi të pavarur në çështjet civile. Gjyqësia vendëse nganjëherë ishte e njëanshme dhe i nënshtrohej ndikimit të jashtëm dhe nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Mediat dhe publiku e konsideronin gjyqësorin të korruptuar, të fshehtë dhe joefikas. Ankesat drejtuar Zyrës së Prokurorit Disiplinor shënuan rënie ndërmjet shtatorit të vitit 2009 dhe gushtit të vitit 2010.

Në nëntor të vitit 2009, Komisioni Evropian raportoi se sistemi gjyqësor i vendit mbeti i dobët në të gjitha nivelet. Komisioni citoi besimin e ulët të publikut në sistemin e drejtësisë, dhe ekzistimin e vazhdueshëm të tri burimeve paralele të legjislacionit (ligjin e ish-Jugosllavisë, rregulloret e UNMIK-ut, dhe ligjin e Kosovës) si probleme të posaçme. Komisioni gjithashtu vuri në pah se numri i madh i rasteve të pazgjidhura gjyqësore mbeti problem serioz. Këshilli Gjyqësor i Kosovës formoi një grup punues për ta zhvilluar një strategji kombëtare për pakësimin e numrit të madh të rasteve të pazgjidhura

Sipas raporteve monitoruese të publikuara nga OSBE-ja në vitin 2009 dhe gjatë këtij viti, procedurat civile gjyqësore dëmtoheshin nga vonesat, dhe aktgjykimeve shpesh u mungonte arsyetimi i nevojshëm. Gjykatësit shpesh dështonin t'i menaxhonin rastet e tyre në mënyrë efikase dhe t'i disiplinon palët që i abuzonin rrugët procedurale për t'i vonuar procedurat.

Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të njeriut, apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut. Në të vërtetë, shumë ankesa të tilla mbetën të pazgjidhura. Individët iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të drejtave të tyre për proces të drejtë. Mbi 60 për qind e rasteve të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese gjatë këtij vitit pohonin për shkelje të të drejtave kushtetuese nga gjykatat, prokurorët apo policia.

Pati probleme në zbatimin e urdhrave të gjykatave civile. P.sh., menjëherë pas një marrëveshjeje të majit të vitit 2009 për zgjidhjen e një kontesti tokësor, komuna e Deçanit publikisht theksoi se nuk do t'i ndryshonte të dhënat pronësore komunale pavarësisht vendimit të mundshëm të Gjykatës Supreme.

Rikthimi i pronës

Sfidat sistematike për rikthimin e pronës vazhdojnë. Një raport i OSBE-së, i marsit të vitit 2009, vlerësoi se shqyrtimi i rasteve të të drejtave pronësore në sistemin ligjor pengohej nga përzierja e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative, praktikave gjyqësore dhe urdhëresave në lëmin e pronës, si dhe në mjedisin e ndërlikuar postkonfliktuoz të vendit.

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) është përgjegjëse për zgjidhjen e kërkesave të pronës rezidenciale, komerciale dhe bujqësore që dalin nga konflikti i Kosovës. Në fund të vitit, kjo agjenci administronte me 3,131 prona të braktisura. Prej tyre, 2,576 administroheshin sipas kërkesës së pretenduesit të suksesshëm, dhe 515 administroheshin në bazë të ndërhyrjeve zyrtare nga Komisioni për kërkesa banesore dhe pronësore (KKBP, agjenci paraardhëse e AKP-së). AKP-ja lëshoi 863 prona me qira në emër të pronarëve legjitimë, të cilët pranuan 2.5 milionë euro (($3.35 milionë) nga qiraja. Në fund të vitit, agjencia kishte pranuar gjithsej 41,099 kërkesa: 36,637 për pronë bujqësore, 979 për pronë komerciale, dhe 3,488 për pronë rezidenciale. Serbët e Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës vazhduan t'i zinin pronat e shqiptarëve dhe ua mohonin qasjen pronarëve të tyre; shqiptarët e Kosovës në pjesën jugore të komunës ua zinin dhe ua mohonin serbëve të Kosovës qasjen në pronën e tyre. AKP-ja ka urdhra për 481 dëbime të pazgjidhura në Mitrovicë, prej tyre 299 janë në Mitrovicën veriore dhe 182 janë në Mitrovicën jugore. Këta 481 urdhra për dëbim përbëjnë 83 për qind të të gjitha dëbimeve të pazgjidhura nga AKP-ja. Gjatë këtij viti, AKP-ja kreu 182 dëbime në mbarë Kosovën.

AKP-ja nuk qe në gjendje t'i zbatonte shtatë vendime të KKBP-së për pronat që gjendeshin në pjesën veriore të Mitrovicës, për shkak të brengave nga autoritetet se përpjekjet për shpërndarjen e njoftimeve për dëbim do të mund të shpinin në dhunë.

AKP-ja gjithashtu i shqyrtoi kërkesat për rishqyrtim në rastet në të cilat kërkesa origjinale ishte mohuar. Që nga dhjetori, një kërkesë e KKBP-së për rishqyrtim mbeti e pazgjidhur. Përveç kësaj, Komisioni i Kosovës për kërkesa pronësore (KKKP), një dorë kuazi-gjyqësore e AKP-së, që vepron nën mandatin e AKP-së, gjykoi 26,953 kërkesa deri në fund të dhjetorit. KKKP hodhi poshtë 18,637 kërkesa kryesisht në bazë të njoftimeve të gabuara apo shkaqeve të tjera teknike. Prej kërkesave të hedhura poshtë, KKKP rigjykoi 1,680 kërkesa. Si i tillë,

numri i kërkesave të vlefshme të gjykuara arrin në 10,266. Numri i përgjithshëm i vendimeve të zbatuara të KKKP-së arrin në 2,249.

Numri i pazgjidhur i ankesave pronësore në gjykata komunale mbeti i lartë, rreth 20,000 në fund të vitit, që paraqitnin pothuaj vetëm kërkesa financiare të serbëve të Kosovës për dëme të lidhura me luftën.

f. Ndërhyrja arbitrare në intimitet, familje, shtëpi, apo korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa në praktikë. Forcat e KFOR-it mbajtën mundësinë për t'i ndihmuar policisë vendëse dhe policisë së EULEX-it në kryerjen e kontrollimeve për të dyshuar të rrezikut të lartë dhe në mënyrë të pavarur kontrollonin pronën private për armë, pa urdhër të gjykatës, duke u bazuar në autoritetin paqeruajtës të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. KFOR-i nuk kreu asnjë kontrollim të tillë gjatë këtij viti.

Seksioni 2 Respektimi i lirive civile, përfshirë këtu:

a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit, dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta në praktikë. Megjithatë, pati raportime që përfaqësuesit e mediave ishin kërcënuar nga zyrtarët publikë, politikanët dhe bizneset. Mediat gjithashtu hasën në vështirësi dhe pengesa me rastin e marrjes së informatave nga institucionet qeveritare dhe publike. Ligji për mediat transmetuese ndalon fjalimin urrejtës dhe fjalimin që nxit dhunë etnike.

Individët në përgjithësi mund t'i kritikonin autoritetet publikisht ose privatisht pa reprezalje.

Sipas Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK), vështirësitë financiare të mediave bënë që pavarësia redaksionale dhe profesionalizmi gazetaresk i mediave të shkruara dhe elektronike t'i nënshtroheshin ndikimit dhe presionit të jashtëm. Disa gazeta ishin financiarisht të pavarura dhe kështu ishin në gjendje të zhvillonin politika redaksionale të pavarura nga biznesi apo interesat politike. Megjithatë, disa gazeta të tjera mbështeteshin në financim nga bizneset apo grupet e interesit politik, si dhe nga Qeveria, që ofronin mbështetje financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo mungesë të raportimit kritik.

Nuk pati censurim të drejtpërdrejtë të mediave të shkruara apo elektronike; megjithatë, gazetarët raportuan për presion nga politikanët dhe krimi i organizuar, që shpesh rezultonte në vetë-censurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale apo për vend të punës. Gazetarëve nganjëherë u ofrohej kompensim financiar në shkëmbim për raportim pozitiv apo për heqje dorë nga ndonjë hetim, dhe disa u kërcënuan gojarisht nga zyrtarë qeveritarë dhe kriminelë të dyshuar për gjoja raportim negativ ndaj tyre. Sipas redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat e rregullta nga gazetat që kishin raportuar në mënyrë kritike për to.

Mediat e shkruara vetë-rregulloheshin përmes një kodi të sjelljes të miratuar nga Këshilli i mediave të shkruara, organizatë e përbërë nga redaktorë dhe botues të mediave të shkruara dhe e drejtuar nga një anëtar ndërkombëtar i zgjedhur nga Këshilli. Bordi për ankesa i Këshillit i shqyrton vendimet dhe nxjerr vendime për ankesat kundër mediave. Këshilli

kërkon nga mediat për të cilat zbulohet se e kanë shkelur kodin e sjelljes të grupit t'i publikojnë gjetjet negative të Këshillit. Sipas statutit të ri të Këshillit, që hyri në fuqi më 26 janar, Këshilli më nuk imponon gjoba për sjellje të keqe.

Komisioni i pavarur për media i zbatoi rregulloret dhe imponoi kodet e sjelljes që i drejtonin mediat transmetuese. Komisioni është organ i përhershëm i mbikëqyrur nga një këshill drejtues 7-anëtarësh.

Që nga dhjetori, vendi kishte 104 transmetues të licencuar në rrjetin tokësor (39 prej tyre transmetonin në gjuhët e pakicave); transmetuesit shprehnin një gamë të gjerë të pikëpamjeve. Prej 65 transmetuesve, gjuhë kryesore e të cilëve ishte shqipja, tri subjekte të grupit të RTK-së (RTK, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky), të financuara publikisht, gjithashtu transmetonin çdo ditë në gjuhët e pakicave.

Bordi i drejtorëve të RTK-së është përgjegjës për mbikëqyrjen e RTK-së, dhe Ministria e Financave e kontrollonte buxhetin e tij. Ligji parashikon rregullimin e përmbajtjes së programit të RTK-së dhe kërkon që së paku 15 për qind e kohës së programit të RTK-së, përfshirë këtu kohën qendrore, t'u kushtohet bashkësive pakicë në gjuhën e tyre përkatëse në baza proporcionale.

Transmetuesi shtetëror, RTK, operonte me financim të përkohshëm të ndarë nga Kuvendi në pritje të ndryshimit të Ligjit për RTK-në. Në tetor të vitit 2009, Gjykata Kushtetuese pezulloi mekanizmin kryesor për financim të RTK-së, parapagimin prej 3.50 euro ($4.70) në muaj që u shtohej të gjitha faturave të rrymës. Ky pezullim bëri që Unioni Evropian i Transmetuesve ta lëshonte një letër publike duke vënë në pah se ky vendim e rrezikonte pavarësinë e transmetuesit.

Nuk pati raportime për censurim apo ngacmim për botim të librave, dhe shtëpitë botuese shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve pa kufizim.

Nuk pati raportime që Qeveria i përdori ligjet për shpifjen, arsyet e sigurisë kombëtare apo publike, apo kufizimet për botim si mjete për t'i kufizuar operacionet e mediave të shkruara, elektronike, apo të shtëpive botuese.

Gjatë këtij viti, AGPK raportoi për 33 raste të abuzimit të lirisë së shtypit nga zyrtarë qeveritarë, gupe afariste të interesit dhe pronarë të mediave, përfshirë këtu kërcënimet verbale ndaj gazetarëve dhe agjencive të tyre nga individët e prekur nga raportimi negativ i mediave, presionin për të mos publikuar materiale dhe artikuj të caktuar, dhe pengim të punës së tyre. AGPK gjithashtu raportoi se shumë gazetarë u ankuan që redaktorët shpesh nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë apo zyrtarë të caktuar për shkak të lidhjeve, ose preferencave, të redaktorëve apo të mediave me zyrtarë të lartë qeveritarë. Në disa raste, gazetarët raportonin që redaktorët i kërcënonin se do t'i largonin nga puna nëse vazhdonin të publikonin storje kritike për Qeverinë. Tre gazetarë raportuan se redaktorët i ndaluan të publikonin storje për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

Më 27 gusht, Organizata e mediave të Evropës Juglindore (SEEMO), me seli në Vjenë, lëshoi një kumtesë për medie lidhur me brengat e veta për kufizim të mundësisë së gazetarëve për të udhëtuar. SEEMO raportoi se disa gazetarëve nuk u ishte lëshuar pasaporta sepse ishin nën hetime apo përballeshin me procedura gjyqësore. Të gjithë personat që paraqesin kërkesë për pasaportë, duke përfshirë gazetarët, duhet ta dorëzojnë një certifikatë të lëshuar nga gjykata

kompetente me të cilën vërtetohet se nuk janë nën hetime apo nuk përballen me procedura gjyqësore. Pasi gazetarët shpesh paditen për raportim kritik dhe janë objekt i vonesave të tepërta gjyqësore, SEEMO e quajti këtë kriter "kufizim të qartë të lirisë së lëvizjes për gazetarë".

Më 14 nëntor, gazetarja e agjencisë së lajmeve Kosovapress, Sebahate Shala, u largua nga puna pas një konference për shtyp, të 13 nëntorit, në të cilën e pyeti një zyrtar të EULEX-it nëse ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Famir Limaj, duhej të ishte i përfshirë në listën e kandidatëve të PDK-së për zgjedhjet për Kuvend, duke pasur parasysh që Limaj ishte subjekt i një hetimi që ishte duke u zhvilluar nga EULEX-i. Shala raportoi se kishte pranuar tekst porosi kërcënuese dhe fyese pas konferencës për shtyp dhe publikimit të raportit të saj për atë konferencë. Shala tha se ishte e detyruar që largohej nga puna për shkak të mosmarrëveshjeve me udhëheqjen e agjencisë lidhur me pyetjen e bërë dhe mbulimin e konferencës për shtyp.

Gjatë këtij viti pati disa incidente të dhunës apo ngacmimit të drejtuara kundër mediave.

Më 13 maj, persona të panjohur vunë mbishkrime në ndërtesa në rrugën në të cilën jetonte drejtoresha e kompanisë Koha, Flaka Surroi. Në mbishkrim thuhej, "Rruga e UDB-së – Veton dhe Flaka Surroi". UDB është shkurtesë për ish-sigurimin shtetëror jugosllav/serb dhe, ndër pjesën më të madhe të popullsisë së vendit është e njëjtë si "tradhtar". Vendosja e mbishkrimeve pasoi pas publikimit të një interviste në të përditshmen Koha Ditore, që ka qarkullimin më të madh ditor, me prokurorin e EULEX-it, Johannes Van Vreeswijk, në të cilën ai zbuloi se ministri i Transportit, Fatmir Limaj, dyshohej për përfshirje në krim të organizuar dhe abuzim të detyrës. Kryeministri Thaçi publikisht e kritikoi vendosjen e mbishkrimeve.

Më 3 qershor, AGPK pranoi një ankesë nga e përditshmja Zëri, në të cilën pohohej që kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Anton Nokaj, kishte ushtruar trysni ndaj gazetës duke u kërcënuar se do të ushtronte kallëzim penal (si qytetar civil) kundër gazetares së kësaj të përditshmeje Besa Kalaja. Nokaj pohonte që Kalaja kishte raportuar në mënyrë të rreme që ishte ngritur akuzë kundër tij në EULEX lidhur me punësimin e të birit të tij si përkthyes në gjykatë. Nokaj nuk u riemërua në postin e tij si gjykatës.

Më 28 qershor, një grup i pjesëmarrësve serbë, që kremtonin përvjetorin e Betejës së Kosovës në Gazimestan, dëmtoi një automjet të kanalit televiziv Top Channel me seli në Tiranë, dega në Kosovë, dhe e gjuajtën me gurë kameramanin. Kameramani e incizoi incidentin dhe nuk ishte lënduar gjatë këtij sulmi. Policia ishte duke hetuar rastin.

Më 20 korrik, një mjet shpërthyes u hodh në oborrin e shtëpisë së kryeredaktorit të Radio Mitrovicës, Çasllav Millisavleviq. Shpërthimi dëmtoi tri vetura të parkuara, njëra prej tyre ishte e Millisavleviqit. Disa media e cituan atë ta ketë quajtur këtë sulm me motive politike për shkak të përfshirjes së të birit të tij në ekipin përgatitor komunal në Mitrovicën veriore, që është duke punuar me qeverinë kombëtare për krijimin e një komune të re me shumicë serbe në kuadër të sistemit administrativ të Kosovës. Hetimet për këtë rast ishin në vazhdim e sipër në fund të vitit.

Pati disa zhvillime në rastet e dhunës apo ngacmimit të drejtuara kundër mediave gjatë viteve të kaluara.

Më 5 maj, prokurorët e EULEX-it raportuan që nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për ta hetuar rastin e janarit të vitit 2009, me ç'rast një grup i serbëve të Kosovës hodhi një mjet shpërthyes në zjarrfikës në pjesën veriore të Mitrovicës dhe sulmoi ekipin televiziv të stacionit lokal TV Most [Ura], që ishte duke xhiruar zjarrin, duke lënduar një reporter dhe shkatërruar një TV kamerë.

Nuk pati zhvillime të reja në rastin e marsit të vitit 2009, në të cilin mediat serbe të Kosovës raportuan se policia i kishte ngacmuar reporterët e produksionit televiziv të serbëve të Kosovës Glas Juga [Zëri i jugut] dhe të KIM Radios pasi kishin xhiruar një protestë të serbëve të Kosovës në fshatin Shillovë. Nga sa thuhet, policët i ndaluan reporterët, e detyruan kameramanin Bojan Kosanin të dilte nga vetura, dhe e shqelmuan. Policia pohoi se nuk kishte marrë asnjë ankesë për keqtrajtim nga ana e policisë.

Gazeta e përditshme Infopress, e cituar nga Këshilli i mediave të shkruara për publikimin e mendimeve që përbënin fjalim urrejtës (kërcënime kundër gazetares Jeta Xharra) nuk e pagoi gjobën prej 1,000 eurove ($1,340) të imponuar nga Këshilli i mediave të shkruara në qershor të vitit 2009. Sipas statutit të ri të Këshillit të mediave të shkruara, Këshilli më nuk imponon gjoba për media.

PK vlerësoi se nuk kishte keqbërje nga policia në ndalimin në korrik të vitit 2009 të një reporteri dhe tekniku të "TV Liria" për gjoja provokim të masës gjersa xhironin një operacion policor që përfshinte arrestimin e dhjetëra nëpunësve të qeverisë komunale të Vitisë në korrik të vitit 2009. Reporteri dhe tekniku u larguan nga stacioni policor, nuk u intervistuan atje, dhe nuk ngritën padi kundër policisë për ndalim. Policia e Vitisë tha më vonë se ngriti padi kundër reporterit dhe teknikut për shkak të pengimit të zyrtarëve në kryerjen e detyrave të tyre, por gazetarët nuk kanë marrë asnjë njoftim për akuzat kundër tyre.

Liria e internetit

Qeveria nuk e kufizoi qasjen në internet, dhe nuk pati raportime që Qeveria i vëzhgonte e-mailat apo bisedat në internet. Individët dhe grupet mund të angazhoheshin në shprehje paqësore të mendimeve përmes internetit, përfshirë këtu e-mailat. Në dhjetor, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit raportoi se rreth 40 për qind e shtëpive kishin lidhje të internetit.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Qeveria nuk e kufizonte lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e grumbullimit paqësor dhe grupimit

Liria e grumbullimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e grumbullimit, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë.

Ligji për tubimet publike kërkon që organizatorët ta njoftojnë policinë për protesta 72 orë para ndodhisë. Policia duhet t'i njoftojë organizatorët brenda 48 orëve nëse protesta do të lejohet.

Gjatë këtij viti, policia përdori forcën në disa raste për t'i shpërndarë demonstratat dhe rrahu demonstruesit gjatë arrestimit.

Pati pohime për përdorim të tepërt të forcës nga policia e EULEX-it në përleshjet e 11 shtatorit ndërmjet një grupi të serbëve të Kosovës dhe EULEX-it e PK-së që ndodhi pas një zënke ndëretnike pas humbjes së Serbisë në gjysmëfinalen e kampionatit botëror në basketboll. Një polic i EULEX-it u plagos me plumb në këmbë, dhe një polic i PK-së dhe shtatë serbë të Kosovës gjithashtu u lënduan në këtë incident. PK ishte duke hetuar rastin në fund të vitit.

IPK hetoi, por nuk lëshoi asnjë konkluzion për rastin e majit të vitit 2009 për enklavën e serbëve të Kosovës në Ranillug të Kamenicës, ku serbët lokalë protestuan kundër ndërprerjes së rrymës nga KEK-u. Pati raporte të besueshme që shumë policë të PK-së për operacione speciale e rrahën dhe shqelmuan një protestues gjersa ishte i shtrirë përtokë. Asnjë polic nuk u akuzua për këtë rast.

Liria e grupimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e grupimit, dhe Qeveria në përgjithësi e respektoi këtë të drejtë në praktikë.

c. Liria e fesë

Për një pasqyrë të plotë të lirisë fetare, luteni të shihni Raportin ndërkombëtar të vitit 2010 mbi lirinë e fesë në: www.state.gov/g/drl/irf/rpt.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve, dhe e personave pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe Qeveria dhe EULEX-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta; megjithatë, tensionet ndëretnike dhe brengat e vërteta e të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes në praktikë.

Qeveria bashkëpunoi me Komisariatin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë PZHBV-ve, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe grupeve të tjera të cenuara.

Policia vazhdoi ta vlerësonte situatën e sigurisë si stabile, por delikate. Policisë nuk iu raportuan krime që kishin të bënin me lirinë e lëvizjes. Megjithatë, anëtarët e të gjitha bashkësive etnike vazhduan të qëndronin kryesisht brenda apo të udhëtonin ndërmjet zonave në të cilat grupi i tyre përbënte shumicën.

Rreziqet e perceptuara dhe incidentet sporadike të dhunës dhe kërcënimit vazhduan ta kufizonin lirinë e lëvizjes për shqiptarë në Kosovën veriore dhe për serbë në pjesët e tjera të vendit. Qeveria i shtoi përpjekjet për ta lehtësuar udhëtimin e pakicave, por rreziqet e vërteta dhe të perceptuara i frenonin shumë pakica që të udhëtonin jashtë lagjeve të tyre.

Pati disa raste të mjeteve shpërthyese të gjetura përgjatë rrugës dhe nën një urë në rajonin e Shtërpcës. Asnjëra nuk shpërtheu.

Nuk pati zhvillime të reja që nga arrestimi i pesë meshkujve në rastin e vitit 2008 për tentim vjedhje të armatosur të një autobusi të udhëtarëve që bartte serbë të Kosovës për në Serbi, afër Podujevës.

Nuk pati zhvillime të reja në incidentet e vitit 2008 në të cilat këmbësorët zbuluan mjete shpërthyese afër hekurudhës në fshatin Kaçanik i Vjetër të Ferizajt dhe nën një urë hekurudhore në Mitrovicë.

Qeveria e rregullonte lëvizjen brenda vendit dhe jashtë tij. Ligji parashikon që zyra qendrore e regjistrimit civil mund t'i lëshojë dokumente të udhëtimit cilitdo person të regjistruar si banor i Kosovës, dhe zyra rregullisht lëshonte dokumente të tilla në praktikë.

Ligji ndalon dëbimin me forcë, dhe autoritetet nuk e përdorën atë.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Sipas UNHCR-së, në fund të vitit kishte rreth 18,196 persona të zhvendosur brenda vendit, 54 për qind e të cilëve ishin serbë të Kosovës dhe 40 për qind ishin shqiptarë të Kosovës. Prej 4,100 personave të zhvendosur nga trazirat në vitin 2004, rreth 1,000 mbetën PZHBV.

Sipas vlerësimeve të UNHCR-së, numri më i madh i PZHBV-ve, rreth 80 për qind, ishte i përqendruar në rajonin e Mitrovicës. Në komunën e Mitrovicës, shumë serbë të Kosovës në pjesën veriore dhe shqiptarë të Kosovës në pjesën jugore të komunës mbetën të zhvendosur.

Donatorët ndërkombëtarë përfunduan ndërtimin e 96 shtëpive për 96 familje në mëhallën e romëve në pjesën jugore të Mitrovicës, që u shkatërrua gjatë trazirave në vitin 1999. Në këto shtëpi janë të vendosura familjet që kanë qenë duke jetuar në kampin për PZHBV në Llugë, të ndotur me plumb, dhe në Osterode. Para ndërtimit të shtëpive të reja, 484 romë, ashkalinj dhe egjiptianë të zhvendosur ishin kthyer në mëhallë këtë vit. Më 2 dhjetor, donatorët ndërkombëtarë financuan një program për testimin e nivelit të plumbit në gjak për 78 fëmijë që ishin risistemuar nga kampet e kontaminuara me plumb gjatë luftës. Në një procedurë testimi dhe trajtimi, të miratuar kohët e fundit nga Ministria e Shëndetësisë, infermieret në qendrën mjekësore në mëhallën e romëve filluan testimin e fëmijëve për helmim nga plumbi. Testimi zbuloi rënie të madhe të nivelit të plumbit në gjak pas risistemimit. Varësisht nga rezultatet shtesë, trajtimi pasues do të kryhet nga zyrtarët shëndetësorë.

Gjatë këtij viti, Ministria për Bashkësi dhe Kthime ndau pesë milionë euro ($6.7 milionë) për kthimin e PZHBV-ve dhe për t'u ndihmuar PZHBV-ve. Bashkësia e donatorëve ndërkombëtarë gjithashtu siguroi mjete financiare për partnerët zbatues të projekteve për kthime në koordinim me Ministrinë për Bashkësi dhe Kthime. Këto fonde u shpenzuan në rindërtimin e shtëpive, për ndihmë në ushqim dhe gjëra joushqimore, në grante për gjenerimin e të ardhurave, dhe mbështetje të infrastrukturës themelore, si të rrugëve dhe sistemeve të ujit.

Qeveria nuk i sulmoi, synoi, ktheu me forcë apo risistemoi PZHBV-të nën kushte të rrezikshme.

PK raportoi që hetimet për katër raste të sulmeve fizike dhe ngacmimit verbal kundër romëve të kthyer që jetonin në Gjilan në korrik të vitit 2009 rezultuan me tri raste të dërguara në prokurorinë komunale dhe me një rast të dërguar në gjykatën komunale për kundërvajtje.

Mbrojtja e refugjatëve

Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatit, apo e Protokollit të vitit 1967. Megjithatë, ligji bazohet dhe i referohet Konventës së vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 për dhënien e statusit të azilantit apo refugjatit, dhe Qeveria ka themeluar një sistem për të ofruar mbrojtje për refugjatë.

Ligji për azil hyri në fuqi në vitin 2008. Urdhëresat administrative, si procedurat dhe standardet për pranimin dhe trajtimin fillestar të azilkërkuesve, dhe të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, janë miratuar dhe pritet të zbatohen. Gjatë këtij viti, UNHCR-ja vazhdoi t'i ndihmonte Departamentit për Kufij, Azil dhe Migrim në ndërtimin e kapacitetit të vet për të gjykuar kërkesa, për të ofruar trajnim për policinë kufitare në identifikimin dhe trajtimin e personave që kërkojnë azil në pika të hyrjes; dhe për ta penguar kthimin e personave në vendin ku jeta apo liria e tyre do të kërcënohej. Përveç kësaj, Qeveria ka nxjerrë një vendim për themelimin e komisionit kombëtar për refugjatë, dhe, me Komisionin Evropian, është duke financuar ndërtimin e një qendre të re për pranimin e azilkërkuesve në komunën e Lipjanit.

Në praktikë, Qeveria siguroi mbrojtje kundër dëbimit apo kthimit të refugjatëve në vendin ku jeta apo liria e tyre do të kërcënohej për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësimit në ndonjë grup të posaçëm shoqëror, apo mendimit politik. Në fund të vitit, vendi strehonte 220 refugjatë, kryesisht nga vendet fqinje.

Sipas një raporti të UNHCR-së, prej janarit të vitit 2009 deri në dhjetor të vitit 2010, 271 azilkërkues paraqitën kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në vend. Departamentit për Kufij, Azil dhe Migrim dhe qendra për azil i akomoduan të gjithë azilkërkuesit. Një qendër e përkohshme për azil u hap në Prishtinë në janar. Ky objekt ishte mbushur deri në kapacitetin e vet në fillim të vitit. Në fund të vitit, prej 272 azilkërkuesve, vetëm 62 mbetën në vend. Shifrat për personat pa shtetësi nuk ishin në dispozicion, por UNHCR-ja raportoi se u kishte ndihmuar rreth 10,000 personave të bashkësisë rome, ashkalike dhe egjiptiane për regjistrimin e gjendjes civile.

Seksioni 3 Respektimi i të drejtave politike: e drejta e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre në mënyrë paqësore, dhe qytetarët e ushtruan këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periodike, të lira e të drejta, në bazë të votimit të përgjithshëm.

Që nga shpallja e pavarësisë së vendit në vitin 2008, zyrtarët vendës morën përsipër autoritetin dhe përgjegjësitë në shumicën e fushave të qeverisjes. Sipas Kushtetutës, Kuvendi 120-anëtarësh ka të drejtë ta zgjedhë presidentin, kryeministrin, ministrat dhe zyrtarët e tjerë të qeverisë.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Më 12 dhjetor, vendi mbajti zgjedhjet për Kuvend, pas votimit për mosbesim ndaj Qeverisë, të mbajtur më 2 nëntor në Kuvend. Votimi për mosbesim pasoi pas dorëheqjes së Presidentit Fatmir Sejdiu më 27 shtator pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese se ai e kishte shkelur Kushtetutën duke mbajtur postin e kryetarit të partisë së tij politike, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), gjersa shërbente si President.

Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendës pohuan që zgjedhjet në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare, por vunë në pah disa parregullsi dhe manipulime të rënda zgjedhore në disa rajone, duke përfshirë falsifikimin e nënshkrimeve në listën e votuesve, dhe vërejtën parregullsi në numërim. Vëzhguesit gjithashtu vërejtën incidente të votimit familjar (kreu i familjes votonte në emër të femrave të familjes) në tërë vendin. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i anuluan rezultatet për tri komuna -- Skenderaj, Drenas dhe Deçan -- si dhe në tri vendvotime në Malishevë dhe Lipjan për shkak të parregullsive zgjedhore. Rivotimi në këto tri komuna dhe në vendvotimet e anuluara në dy komunat e tjera ishte caktuar për 9 janar 2011.

Për zgjedhjet e 12 dhjetorit për Kuvend, 14 vendvotime alternative -- minibusë të plotësuar me ndërkombëtarë dhe që i reklamonin zgjedhjet në publik -- u siguruan për t'i shtuar mundësitë e votimit në zonat serbe në veri të lumit Ibër. Organet zgjedhore nuk kishin qasje në shkolla që normalisht shërbejnë si vendvotime, pasi këto institucione janë nën kontroll të organeve të palejuara paralele të qeverisë serbe. Kërcënimet e ashpra në përgjithësi i pengonin personat vendës të shërbenin si punëtorë të vendvotimeve dhe e pengonin daljen e votuesve në zgjedhje.

Më 29 tetor, Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme që sqaroi procesin zgjedhor për ankesa dhe parashtresa dhe mundësoi që votuesit të votojnë për një parti dhe deri në pesë kandidatë të asaj partie për zgjedhjet për Kuvend.

Më 20 qershor, zgjedhjet komunale u mbajtën në komunën e sapothemeluar me shumicë serbe të Parteshit, dhe rivotimi për kryetar të komunës u mbajt më 18 korrik. Zgjedhjet në Partesh u shënuan me shkallën më të lartë të pjesëmarrjes së serbëve të Kosovës qëkur vendi u bë i pavarur, dalja në raundin e parë të zgjedhjeve ishte mbi 56 për qind dhe raundi i dytë arriti në 36 për qind. Vëzhguesit ndërkombëtarë i vlerësuan zgjedhjet në përgjithësi të lira dhe të drejta. Për shkak të vdekjes së kryetarit të komunës së Istogut, zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar u mbajtën më 11 prill.

Ithtarët serbë që e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës vazhduan t'i kërcënonin dhe t'u hakmerreshin serbëve të Kosovës që u angazhuan në strukturat e Qeverisë së Kosovës. Më 27 shtator, mjete shpërthyese, që besohej të ishin granata dore, u hodhën në shtëpinë e Dragan Stojkoviqit dhe në veturën e Dushan Millisavleviqit, zyrtarë të partisë së vetme politike të regjistruar ligjërisht në Kosovën veriore, Partia Alternativa Demokratike, pas kongresit të saj inaugurues. Sulmi i 27 shtatorit ishte sulmi i tretë ndaj pronës së Stojkoviqit dhe i dyti ndaj veturës së Millisavleviqit.

Vendi kishte një sistem shumëpartiak të dominuar nga pesë parti politike shqiptare me disa parti më të vogla dhe koalicione të pakicave. Ligji parashikon që individët mund ta propozojnë veten si kandidatë të partive të tyre, të cilat duhet të mbajnë zgjedhje të brendshme, të hapura e transparente, për t'i zgjedhur listat e kandidatëve. Partitë politike mund të vepronin pa kufizim apo ndërhyrje të jashtme, por lidhja partiake luante rol të rëndësishëm në qasje në shërbime qeveritare e sociale dhe në mundësi për punësim.

Marrëveshjet tradicionale shoqërore dhe besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të rëndësishëm, ndonëse jozyrtar, në organizatat politike.

37 femra ishin në Kuvendin 120-anëtarësh, para se të shpërndahej në nëntor. Ligji për zgjedhje kërkon që femrat të përbëjnë 30 për qind të parlamentarëve. Nuk kishte asnjë femër në kryesinë 8-anëtarëshe të Kuvendit. Në Qeveri, dy femra ishin ministre dhe katër femra ishin zëvendësministre. Ndonëse asnjë femër nuk u zgjodh kryetar komune në zgjedhjet e nëntorit, ato përbënin 31 për qind të përfaqësuesve të zgjedhur komunalë.

24 anëtarë të pakicave etnike ishin në Kuvendin 120-anëtarësh, para se të shpërndahej në nëntor, duke përfshirë 10 serbë dhe 14 anëtarë të grupeve të tjera, përfshirë këtu turqit, boshnjakët, goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.

Kushtetuta kërkon që Kuvendi t'i rezervojë 10 vende për serbët e Kosovës dhe 10 vende për anëtarët e grupeve të tjera etnike. Ndonëse nuk ka kuota të ngjashme për zgjedhjet komunale, pjesëmarrja politike dhe përfaqësimi i serbëve të Kosovës në pjesën jugore të vendit vazhdoi të rritej, posaçërisht në komunat me shumicë serbe të sapothemeluara apo të zgjeruara në përputhje me planin Ahtisari dhe Kushtetutën e vendit. Serbët mbetën pa përfaqësim komunal në tri komunat veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, pasi votuesit serbë të Kosovës iu përgjigjën thirrjeve të autoriteteve serbe për të mos marrë pjesë në zgjedhjet komunale të nëntorit të vitit 2009.

Në vitin 2008, Qeveria miratoi një ligj për zgjedhje, për ta krijuar një zonë të vetme zgjedhore, shumanëtarëshe në tërë vendin. Sipas ligjit, zgjedhjet duhet të mbahen me lista të hapura sipas një sistemi proporcional shumicë. Një sistem i kuotës parashikon përfaqësim për femra dhe pakica në Kuvend. Partia politike duhet të marrë 5 për qind të votave për të hyrë në Kuvend.

Qeveria serbe vazhdoi të udhëhiqte struktura paralele të qeverisë në enklavat serbe në Kosovë. Në vitin 2008, UNMIK-u theksoi se organizimi i zgjedhjeve për këto struktura paralele ishte shkelje e Rezolutës 1244 të KSKB-së. Në vitin 2008, UNMIK-u deklaroi se strukturat paralele komunale që dolën nga këto zgjedhje ishin të paligjshme.

Më 14 tetor, një gjykatë e palejuar paralele e qeverisë serbe, që vepronte në Mitrovicën veriore ngriti aktakuza për kryetarin e komunës së Shtërpcës dhe nëntë anëtarë të tjerë të kuvendit komunal dhe nëpunës të komunës së Shtërpcës. Në këto aktakuza, që buronin nga marrja përsipër më 14 janar e disa zyrave në ndërtesën e kuvendit në Shtërpce, që shfrytëzoheshin nga strukturat paralele serbe, kryetari dhe zyrtarët komunalë akuzohen për vepra penale sipas kodit penal të Serbisë. Sipas aktakuzave, kryetari dhe zyrtarët komunalë rrezikojnë të arrestohen nëse udhëtojnë prej Kosovës për në Serbi apo në ndonjë vend që ka marrëveshje ekstradimi me Serbinë.

Më 30 maj, Qeveria serbe sponsorizoi zgjedhjet paralele komunale në Mitrovicë dhe Novobërdë për t'i zëvendësuar qeveritë paralele komunale të shpërndara nga qeveria serbe në dhjetor të vitit 2009. Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare vazhduan të theksonin se institucionet paralele ishin joligjore dhe të pavlefshme.

Seksioni 4 Korrupsioni zyrtar dhe transparenca qeveritare

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion zyrtar; megjithatë, Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase, dhe thuhej që zyrtarët përfshiheshin në praktika të korrupsionit pa u ndëshkuar. Sipas raportit të vitit 2010 të Freedom House, Shtetet në tranzicion, korrupsioni mbeti problem serioz.

Pati perceptim të gjerë publik për korrupsion në Qeveri. Organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vazhduan të raportonin se korrupsioni ishte problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan korrupsionit në Qeveri.

Më 15 tetor, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër pesë të pandehurve kosovarë për trafikim me organe të njeriut, krim të organizuar, veprimtari të paligjshme mjekësore, dhe abuzim të autoritetit zyrtar. Ndër të pandehurit ka mjekë dhe një person që më parë punonte në një post të lartë në Ministrinë e Shëndetësisë. Edhe Interpoli lëshoi urdhër arreste për një shtetas turk dhe një shtetas izraelit lidhur me këtë rast. Akuzat kanë të bëjnë me klinikën Medikus në Prishtinë, e cila u mbyll në vitin 2008 nga PK-ja pas një hetimi disa mujor për trafikim ndërkombëtar të organeve.

Më 10 nëntor, një kolegj i përzier, i përbërë nga dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjykatës kosovar i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i shpalli fajtorë kryetarin e Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD), Nexhat Daci, dhe ish-ndihmësin e tij Ahmet Alishani, për shpërdorim të zyrës gjatë mandatit të Dacit si kryetar i Kuvendit në vitin 2003-05. Gjykata e dënoi Dacin për keqpërdorim të fondeve të Kuvendit për pagimin e faturave të tij dentare dhe optike në vlerë prej 1,540 eurove ($2,063); ai u lirua nga akuzat që kishin të bënin me prokurim të paligjshëm të gjeneratorëve për rezidencën e tij personale. Gjykata e dënoi Dacin me një vit e gjashtë muaj burg me kusht dhe ia ndaloi të ushtronte funksione publike dy vjet pas përfundimit të dënimit; Alishani u dënua me gjashtë muaj me kusht. Sipas dispozitave të dënimit, asnjëri prej tyre nuk do ta vuajë dënimin nëse nuk kryejnë vepra të tjera penale.

Më 13 korrik, pjesëtarët e Task Forcës Anti-Korrupsion dhe policia e EULEX-it e arrestuan Ilir Tolajn, këshilltar politik i ministrit të Shëndetësisë, Bujar Bukoshi, nën dyshimin për shmangie të tatimit për periudhën 2004-08, kur ishte sekretar i përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë. Ai u lirua të nesërmen me kaucion prej 50,000 eurove ($67,000). Hetimet ishin në vazhdim e sipër në fund të vitit

Më 23 korrik, njësitë e EULEX-it dhe të KP-së e arrestuan guvernatorin e Bankës Qendrore, Hashim Rexhepi, nën dyshimin për abuzim të pozitës zyrtare, korrupsion, ryshfet, shmangie të tatimit dhe shpëlarje të parave. Task Forca Anti-Korrupsion kontrolloi shtatë lokacione lidhur me këtë rast, duke përfshirë zyrën e guvernatorit në Bankën Qendrore dhe rezidencën e tij. Më 20 nëntor, Rexhepi u liria me kaucion prej 20,000 eurove ($26,800).

Korrupsioni dhe ndikimi i Qeverisë mbetën problem ndër forcat e sigurisë. Më 16 dhjetor, EULEX-i dhe PK-ja ekzekutuan urdhra për bastisje në Doganën e Kosovës dhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave në lidhje me importimin e sasive të mëdha të cigareve në vitin 2008-09. Hetuesit e EULEX-it kanë pohuar që drejtori i Doganës, Naim Huruglica, ishte bashkëfajtor në një skemë për t'ia privuar Qeverisë 2.5 milionë euro ($3.35 milionë) nga të ardhurat tatimore po të importoheshin cigaret pas ngritjes së planifikuar të akcizës, që hyrë në fuqi në vitin 2009. Rasti mbetet nën hetime, dhe asnjë akuzë nuk është ngritur deri në fund të vitit.

Hetimi vazhdoi në rastin e gushtit të vitit 2009 për togerin e policisë Sejdi Zeqiri, i cili u arrestua për abuzim të autoritetit zyrtar, ryshfet dhe ngacmim seksual. Në fund të vitit, Zeqiri mbeti në arrest shtëpiak.

Njësia e Doganës së Kosovës për Zbatim të Ligjit shënoi përparim në hetimin dhe ndjekjen e korrupsionit në Shërbimin Doganor. Gjatë këtij viti, një zyrtar doganor u pushua nga puna, një u suspendua, dy u degraduan, nëntë zyrtarëve iu mohua gradimi, dhe 15 zyrtarëve iu lëshuan vërejtjet në hetime të ndryshme të brendshme për keqbërje brenda Shërbimit Doganor

Nuk pati zhvillime në rastin e qershorit të vitit 2009, arrestimi i Ardian Hasanajt, zyrtar i lartë në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës (PKT). Hasanaj gjoja mori ryshfet nga dy persona për t'u ndihmuar që të gjenin punë. Hasanajt iu shkëput marrëdhënia e punës me PTK-në pas arrestimit.

Më 14 korrik, Gjykata Komunale në Prizren e dënoi Elez Hoxhën me katër vjet burg dhe me 10,000 euro ($13,400) për marrje të ryshfetit gjatë periudhës 2005-07, kur ishte gjykatës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Më 9 korrik, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e shpalli fajtor shtetasin norvegjez Ove Johansen nën akuzat për korrupsion për aranzhim të transferimit mashtrues të 300,000 eurove ($402,000) prej PTK-së tek një kompani fantazmë me seli në Norvegji. Gjykata e dënoi me dy vjet burg dhe e urdhëroi t'ia paguante PTK-së dëmin në shumë prej 300,000 eurove ($402,000). Dy të dyshuarit e tjerë, Roger Reynolds dhe Ronnen Sorensen mbetën në liri.

Ligji parashikon që zyrtarët publikë duhet t'i respektojnë ligjet për zbulim financiar.

Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (AKK) dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë dy agjencitë kryesore përgjegjëse për luftimin e korrupsionit në Qeveri. Gjatë këtij viti, AKK kishte pranuar 132 raporte për korrupsion; 27 raste ishin ngritur për ndjekje penale, katër i ishin kaluar PK-së, 54 ishin mbyllur për shkak të mungesës së dëshmive, dhe 44 raste ishin në hetim e sipër.

Zyra e pavarur e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kontrolloi menaxhimin dhe përgjegjësinë fiskale në Qeverinë qendrore, në organet komunale dhe në ndërmarrjet publike. Gjatë këtij viti, ZAP auditoi shumicën e ministrive, Zyrën e Presidentit dhe Kuvendin. Në një raport të shtatorit, ZAP theksoi se institucionet qeveritare vazhdonin të mos i respektonin ligjet dhe rregulloret për menaxhim fiskal për shkak të mungesës së kuptimit të përgjegjësive të veta dhe kontabilitetit themelor.

Në një raport të lëshuar gjatë këtij viti, Freedom House theksoi se korrupsioni ishte i përhapur dhe mbeti problem madhor për shkak të ligjeve të pamjaftueshme, mungesës së vullnetit politik dhe dobësisë së sistemit gjyqësor. Raporti gjithashtu theksoi se ligji kundër korrupsionit dhe kodi i përkohshëm penal e definonin korrupsionin në mënyra të ndryshme.

Në vitin 2009, Komisioni Evropian raportoi se roli tejet i madh i sektorit publik rezultoi në një mjedis të pafavorshëm afarist në të cilin grupet dhe individët me lidhje politike kanë përparësi me rastin e themelimit të kompanive dhe kërkimit të kontratave publike.

Ligji parashikon qasje publike në informatat qeveritare përmes Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, të miratuar më 10 tetor, që e shfuqizoi Ligjin e vitit 2003. Ligji i ri parashikon gjoba për institucionet dhe zyrtarët që nuk ofrojnë qasje në informata siç kërkohet me ligj. OJQ-të kanë komentuar në mënyrë të favorshme për ligjin e ri, duke thënë se ai i sqaron procedurat për qasje në dokumente zyrtare.

Një test i kryer nga OJQ-ja "Iniciativa rinore për të drejtat e njeriut", që mbulon periudhën prej tetorit të vitit 2008 deri në korrik të vitit 2009, tregoi se vetëm rreth 25 për qind e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare (që rastësisht u dërgoheshin organeve lokale dhe qendrore) pranonin përgjigje pozitive. Indeksi për qëndrueshmërinë e mediave i Bordit ndërkombëtar për shkëmbim dhe hulumtim theksoi se urdhëresa administrative për zbatimin e Ligjit të vitit 2003 për Qasje në Dokumente Zyrtare e vazhdonte afatin mbi 15 ditë dhe ishte tejet specifike lidhur me atë se kur mund të kihet qasje në një dokument, duke e kufizuar kështu qasjen në dokumente zyrtare.

Seksioni 5 Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi punoi pa kufizim, duke hetuar dhe botuar konkluzionet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria nganjëherë bashkëpunonte dhe u përgjigjej pikëpamjeve të tyre.

Qeveria nganjëherë takohej me monitorues të OJQ-ve vendëse, u përgjigjej pyetjeve të tyre, apo ndërmerrte masa si reagim ndaj raporteve apo rekomandimeve të tyre. Nuk pati raportime që Qeveria ngacmoi, synoi apo ndoqi penalisht OJQ-të për shkak të veprimtarive të tyre.

Qeveria bashkëpunoi me organizatat ndërkombëtare, përfshirë këtu përfaqësuesit e OKB-së dhe me organizata të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë ICRC-në dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim. OKB-ja mbajti një prani të madhe në vend dhe mbuloi një gamë të gjerë të çështjeve.

Nuk pati zhvillime në rastin e vitit 2008 në të cilin sulmues të panjohur hodhën një koktej Molotovi në selinë e organizatës humanitare "Norewgian Church Aid" (Ndihma e kishës norvegjeze) në Mitrovicë.

Avokati i Popullit i heton pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit nga ana e Qeverisë. Avokati i Popullit konsiderohej mjaft efikas, por kufizohej nga problemet financiare. Avokati i Popullit vazhdoi të pohonte se gjykatat dhe ministritë ishin shkelësit më të shpeshtë të të drejtave të njeriut në vend. Avokati i Popullit gjithashtu vuri në pah se reformat e fundit në gjyqësi nuk ishin të mjaftueshme, dhe se sistemi vuante nga të meta serioze. Ndonëse Avokati i Popullit aktivisht lëshonte letra ndërhyrjeje, raporte dhe rekomandime, ato nuk zbatoheshin gjithmonë nga Qeveria, gjykatat lokale, apo policia. Avokati i Popullit hetonte rastet që kishin të bënin me të drejta pronësore, abuzim të autoritetit zyrtar, akte administrative apo neglizhencë të autoriteteve publike, mungesë të hetimeve të mirëfillta për vepra penale, çështje ku përfshihej kohëzgjatja e procedurave gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, konteste lidhur me punësimin, dhe raste të diskriminimit.

Kuvendi ka një Komision për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione. Komisioni duhet t'i shqyrtojë të gjitha ligjet që ndikojnë në të drejtat e njeriut.

Komisioni kontrollohej nga partitë e koalicionit qeverisës dhe nuk lëshoi asnjë raport publik gjatë këtij viti.

Qeveria dhe KFOR-i në përgjithësi bashkëpunuan me TPNJ-në. Më 21 korrik, Dhoma e Apelit e TPNJ-së urdhëroi rigjykim të pjesshëm në rastin e ish-Kryeministrit Ramush Haradinaj dhe të bashkëpandehurit Idriz Balaj, të liruar nga TPNJ-ja në vitin 2008, dhe urdhëroi arrestimin e tyre. Më 28 tetor, prokurori i TPNJ-së e ndryshoi aktakuzën kundër Haradinajt. Ndryshimet e bëra i kanë zëvendësuar "krimet kundër njerëzimit" me "shkeljet e zakoneve të luftës". Ankesa e Lahi Brahimajt, i cili u shpall fajtor për torturim dhe keqtrajtim të të burgosurve dhe u dënua me 6 vjet burg në vitin 2008, nuk u shqyrtua deri në fund të vitit.

Seksioni 6 Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Ligji posaçërisht ndalon diskriminimin në bazë të racës, gjinisë, prejardhjes etnike, aftësisë së kufizuar, statutit shoqëror apo gjuhës. Qeveria nuk i zbatonte në mënyrë efikase këto ndalesa.

Femrat

Ligji e konsideron dhunimin vepër penale; megjithatë, dhunimi bashkëshortor nuk u trajtua në mënyrë të posaçme. Sipas kodit penal, dhunimi dënohet prej 2 – 10 vjet burg; dhunimi i të miturës (marrëdhënia seksuale me një fëmijë nën moshën 16-vjeçare) dënohet prej 5 – 20 vjet burg. Dhunimi që përfshin vrasjen dënohet prej 10 – 40 vjet burg.

Vëzhguesit besuan që nuk u raportua në masë të madhe për dhunimin për shkak të turpit kulturor që u bashkëngjitej viktimave dhe familjeve të tyre. Njësitë policore kundër dhunimit pranuan 18 raporte për dhunim në gjysmën e parë të këtij viti. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, avokatët e viktimave u ofruan shërbime viktimave në 40 raste të dhunimit prej janarit deri në nëntor.

Dhuna në familje ndaj femrave, duke përfshirë abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz dhe i vazhdueshëm. Ligji ndalon dhunën në familje dhe parasheh dënime me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet. Ligji i trajton rastet e dhunës në familje si raste civile, nëse viktima nuk ka pësuar lëndime trupore. Dështimi për ta respektuar aktgjykimin e një gjykate civile që ka të bëjë me dhunën në familje është vepër penale dhe mund të ndiqet penalisht. Kur viktimat ngrinin padi, njësitë policore për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve. Sipas prokurorisë speciale, besnikëritë familjare, varfëria, dhe numri i rasteve të grumbulluara në gjykatat civile dhe penale i kontribuuan shkallës së ulët të ndjekjes penale.

Në nëntor të vitit 2009, OSBE-ja azhurnoi raportin e vet të vitit 2007 për dhunën në familje. Monitoruesit e OSBE-së raportuan për probleme të vazhdueshme në gjykimin e rasteve të dhunës në familje, duke përfshirë vonesat e paligjshme në caktimin e seancave dëgjimore apo në vendosjen lidhur me urdhrat për mbrojtje, dështimin për t'i përfshirë përfaqësuesit e Qendrës për Punës Sociale në procedurat civile të dhunës në familje, përdorimin e gabuar të ligjeve përkatëse nga gjykatat, dhe dështimin e prokurorëve vendës për t'i ndjekur penalisht krimet e dhunës në familje.

Policia raportoi për 636 viktima të dhunës në familje ndërmjet janarit dhe nëntorit. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve në Prishtinë dhe Mitrovicë u ofroi ndihmë 182 viktimave të dhunës në familje dhe të dhunës seksuale, dhe gjashtë viktimave të trafikimit

ndërmjet janarit dhe dhjetorit. Njësia e Ministrisë së Drejtësisë për mbrojtje dhe ndihmë për viktima u angazhua në 313 raste të dhunës në familje prej janarit deri në qershor.

Dënimet për raste të dhunës në familje ishin të rralla dhe silleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënim me burg. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave në shoqërinë e dominuar nga meshkujt i kontribuuan shkallës së lartë të abuzimit në familje dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara.

Sektori për mbrojtjen e familjes i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale kishte një njësi që merrej vetëm me dhunën në familje. Ministria u siguroi pak përkrahje financiare OJQ-ve që drejtonin strehimore për viktima të dhunës në familje, ku ishin të vendosura edhe disa viktima të trafikimit. Ministria gjithashtu siguroi shërbime sociale përmes Qendrave për Mirëqenie Sociale. Disa OJQ vendëse e ndërkombëtare zhvilluan aktivitete për t'u ndihmuar femrave; megjithatë, ato ishin të kufizuara nga tradita e heshtjes lidhur me dhunën në familje, abuzimin seksual dhe dhunimin.

Shkolla për trajnimin e policisë ofronte kurse speciale mbi dhunën në familje dhe dhunimin. Nuk pati raportime që policia reagoi pa vend ndaj supozimeve për dhunim apo abuzim në familje.

Nuk ka ligj të posaçëm kundër ngacmimit seksual, që ishte problem i rëndomtë. Organizatat për të drejtat e gruas treguan se ngacmimi seksual zakonisht ndodhte në vend të punës, por kalonte i paraportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo për hakmarrje fizike. Vetëdijesimi publik për ngacmim seksual mbeti i ulët, dhe pak raste u raportuan.

Ligji për shëndetin riprodhues i mbron të drejtat riprodhuese të individëve dhe çifteve, duke përfshirë të drejtën për informim dhe qasje në shërbime riprodhuese. Në praktikë, Qeveria i respektoi të drejtat riprodhuese. Fondi i OKB-së për Popullatë (UNFPA) raportoi se qasja në informim dhe trajtim të shëndetit riprodhues ishte në përgjithësi e përhapur dhe e drejtë; megjithatë, bashkësitë e varfra, të margjinalizuara dhe të pashkolluara shpesh kishin qasje të kufizuar në informata. Qendrat shëndetësore ofronin trajtim të kufizuar për sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe kancerin e organeve riprodhuese.

Femrat kanë të drejta të njëjta ligjore si meshkujt, por tradicionalisht kanë status më të ulët shoqëror, gjë që ndikoi në trajtimin e tyre brenda sistemit ligjor. Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit ka mandat për ta zbatuar dhe monitoruar Ligjin për Barazi Gjinore.

Relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici, apo Qeveri. Femrat përbënin më pak se 30 për qind të fuqisë punëtore të Qeverisë. Sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, femrat posedonin më pak se 5 për qind të bizneseve të regjistruara. Shkalla e papunësisë së femrave mbeti në rreth 80 për qind, 25 – 30 për qind më e lartë se shkalla e papunësisë për meshkuj. Gjatë këtij viti, Agjencia për Barazi Gjinore mbështeti një OJQ vendëse që ofronte trajnim për femra në biznese të vogla.

Sipas OSBE-së, femrat që u takonin bashkësive joshumicë ishin në rrezik të pësonin nga forma të shumta të diskriminimit për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike, apo prejardhjes shoqërore. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave rezultuan në diskriminim. Në zona rurale, femrat shpesh kishin pak mundësi për të marrë vendime ku përfshiheshin fëmijët e tyre ose për të ushtruar kontroll mbi pronën. Ndonëse ligji nuk bën dallim në gjini lidhur me

të drejtën për ta trashëguar pronën, prona e familjes zakonisht u kalohet vetëm meshkujve. Në raste të rralla, të vejat shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kalohen familjes së babait të vdekur, ndërsa e veja të kthehet në familjen e saj.

Fëmijët

Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend. Sipas një studimi të vitit 2008 të Fondit të OKB-së për Fëmijë (UNICEF), 14 për qind e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë në zonat e Kosovës me shumicë shqiptare nuk regjistroheshin kur lindnin. Në zonat e Kosovës me shumicë serbe, 5 për qind e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë nuk regjistroheshin siç duhej. UNICEF-i raportoi se, si rregull, mungesa e regjistrimit nuk ndikoi në mundësinë fëmijëve për shkollim fillor apo kujdes shëndetësor, por mund të kishte ndikim negativ në qasjen në ndihmë sociale.

Nuk diheshin përmasat e abuzimit të fëmijëve në vend, por UNICEF-i besonte që ky problem nuk raportohej sa duhej për shkak të mungesës së vetëdijesimit, shërbimit për viktima dhe mundësisë së kufizuar për t'i identifikuar, raportuar, dhe referuar rastet e abuzimit. Njësia e Ministrisë së Drejtësisë për mbrojtje dhe ndihmë për viktima raportoi për gjashtë raste të abuzimit të fëmijëve ndërmjet janarit dhe nëntorit. Fëmijët gjithashtu vuanin nga dhuna në familje. Gjatë të njëjtës periudhë, policia raportoi për 60 fëmijë viktima të dhunës në familje. Prej tyre, 23 ishin vendosur në strehimore; 12 ishin nga Kosova dhe 11 ishin nga vendet e tjera.

Pati dëshmi anekdotike për martesë të fëmijëve, posaçërisht ndër bashkësitë rome, ashkalike, egjiptiane dhe shqiptare. Qeveria dhe OJQ-të nuk mblodhën të dhëna për martesën e fëmijëve, kështu që përmasa e këtij problemi ishte e paqartë.

Dhunimi i të miturës është vepër penale që dënohet prej 5 – 20 vjet burg, varësisht nga rrethanat dhe mosha e viktimës.

Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personi që prodhon, përdor apo përfshin një fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë dënohet prej një deri në pesë vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Prej janarit deri në qershor, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale drejtoi 35 qendra për mirëqenie sociale, që u ndihmuan 1,435 jetimëve dhe 1,626 fëmijëve delinkuentë. Ministria gjithashtu menaxhoi jetimoret dhe koordinoi punën me OJQ për t'i vendosur fëmijët në strehimore të përkohshme. Gjatë këtij viti, 61 fëmijë jetonin në jetimore dhe shtëpi të financuara nga OJQ-të apo Qeveria nën kujdes 24-orësh, duke përfshirë 54 fëmijë që u vendosën në kujdes mbrojtës këtë vit. Dy fëmijë që u vendosën në kujdes mbrojtës u shtruan në spital dhe qëndruan atje në fund të çerekut të dytë të këtij viti.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale raportoi se 258 fëmijë të braktisur me aftësi të kufizuara, të moshës prej tre deri në 18-vjeç, jetonin në dy shtëpi të financuara nga Qeveria nën kujdes 24-orësh.

Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Hagës të vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës Për informata mbi rrëmbimin ndërkombëtar prindëror të fëmijës, shih Raportin vjetor të Departamentit të Shtetit në: http://travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport_4308.html.

Antisemitizmi

Nuk pati raportime për akte antisemitike gjatë këtij viti.

Trafikimi i personave

Për informata mbi trafikimin e personave, shih Raportin vjetor të Departamentit të Shtetit mbi Trafikimin e Personave në: www.state.gov/g/tip.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore në punësim, shkollim, qasje në kujdes shëndetësor, dhe në ofrim të shërbimeve të tjera shtetërore; megjithatë, Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase ligjet dhe programet për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara kanë qasje në ndërtesa, informata dhe komunikim. Situata për personat me aftësi të kufizuara mbeti e vështirë. Ndonëse ligji urdhëron qasjen në ndërtesa zyrtare, ai nuk u zbatua dhe qasja e tillë rrallë ishte në dispozicion në praktikë. Edhe Zyra e Avokatit të Popullit nuk është e qasshme për personat me aftësi të kufizuara fizike. Gjatë këtij viti, vendi miratoi ligje të reja që sigurojnë qasje për personat e shurdhër dhe të verbër në të gjitha institucionet publike, por zbatimi i këtyre ligjeve ishte i dobët.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është agjenci e Qeverisë që është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Sipas ligjit, mbrojtja dhe shërbimet u ofrohen të gjithë qytetarëve; megjithatë, pati diskriminim të madh në praktikë, dhe sigurimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara nuk ishte prioritet i Qeverisë.

Sipas OJQ-së vendëse për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, "HandiKos", ligjet ekzistuese dhe planet e Qeverisë për veprim lidhur me personat me aftësi të kufizuara nuk zbatoheshin në mënyrë adekuate. Si rrjedhojë, fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh përjashtoheshin nga mundësitë edukative, nuk vlerësoheshin në mënyrë profesionale, dhe kishin mungesë të shërbimeve të mjaftueshme shëndetësore dhe sociale.

Sipas Ministrisë së Arsimit, në Kosovë ekzistonin shtatë shkolla speciale për fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe 70 klasë për fëmijë me nevoja speciale u ishin shtuar shkollave të rregullta. Ministria raportoi se në fund të vitit, 1,100 nxënës pranonin shkollim special.

Pati mbrojtje ligjore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ligji i ri për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme hyri në fuqi në qershor të vitit 2008, dhe Ligji i ri për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me paaftësi të përkohshme hyri në fuqi më 1 janar. Këto ligje parashikojnë përkufizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe u lejon kujdestarëve të tyre ligjorë të konkurrojnë për përkrahje materiale pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, Ministria nuk kishte as fonde as personel për t'i zbatuar këto ligje.

Sipas OJQ-së "Kosovo Mental Disability Rights International" (K-MDRI), personat me aftësi të kufizuara mendore vazhdonin të mbaheshin të izoluar pa kurrfarë baze ligjore. K-MDRI vuri në pah se nuk ka ligj për ta rregulluar procesin e dërgimit të personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose social, apo për t'i mbrojtur të drejtat e tyre brenda institucioneve. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), kishte rreth 14,000 persona me aftësi të kufizuara mendore; K-MDRI raportoi se rreth 50,000 persona me aftësi të kufizuara mendore jetonin jashtë institucioneve. Sipas K-MDRI-së, personat e tillë çonin jetë të izoluar dhe të stigmatizuar.

Instituti i Shtimes, i drejtuar nga Qeveria, mbante një objekt për persona me aftësi të kufizuara zhvillimore ose intelektuale, me 58 banorë, të udhëhequr nga Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale, dhe një objekt të veçantë psikiatrik me 57 banorë, të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë. Duke cituar trajnimin e pamjaftueshëm për personel dhe mungesën e programit rehabilitues për pacientë dhe banorë, K-MDRI-ja këshilloi që objekti të mbyllej dhe pacientët dhe banorët e tij të vendoseshin në shtëpi dhe banesa në zonat urbane, ku mund të integrohen në bashkësi.

Gjatë këtij viti, Ministria e Shëndetësisë angazhoi një person me nevoja të posaçme për të kontaktuar me personat me aftësi të kufizuara. Ministria e Shëndetësisë drejtoi tetë shtëpi për integrim dhe riedukim anembanë vendit, që u ofronte shërbim 75 personave me aftësi të kufizuara mendore. Përveç kësaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu drejtoi nëntë shtëpi të tjera për riedukim me nga 10 deri në 15 banorë. K-MDRI raportoi se, ndonëse këto shtëpi ishin të menduara si të përkohshme, shumica e banorëve kaluan vite të tëra në to me pak gjasa për t'u integruar në bashkësi. Sipas OBSH-së, nuk kishte objekte të mjaftueshme për të siguruar kujdes për personat me aftësi të kufizuara mendore, dhe mundësitë për punësimin e personave me aftësi të kufizuara mendore ishin të kufizuara.

Këshilli Nacional për Persona me Aftësi të Kufizuara, një organizatë këshillimore për organet e Qeverisë dhe për Kuvend, u takua dy herë gjatë këtij viti.

Pakicat kombëtare/raciale/etnike

Diskriminimi zyrtar dhe shoqëror i bashkësisë serbe, rome, ashkalike dhe egjiptiane sa i përket punësimit, arsimit, shërbimeve sociale, përdorimit të gjuhës, lirisë së lëvizjes, të drejtës për t'u kthyer, dhe të drejtave të tjera themelore, vazhdoi. Anëtarët e bashkësisë boshnjake dhe gorane gjithashtu u ankuan për diskriminim, ndërsa bashkësitë kroate dhe malazeze formalisht pranoheshin përmes emërimit të përfaqësueseve të tyre në Këshillin Konsultativ të Presidentit të Kosovës për Bashkësi. Udhëheqësit boshnjakë të Kosovës vazhduan të ankoheshin se shumë anëtarë të bashkësisë së tyre vazhduan të largoheshin nga vendi për shkak të diskriminimit dhe mungesës së mundësive ekonomike. Anëtarët e bashkësisë rome, ashkalike dhe egjiptiane vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik; shpesh u mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor, dhe shkollim; dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë. Raportet për dhunë dhe krime të tjera të drejtuara kundër pakicave dhe pronës së tyre vazhduan.

Pati përleshje ndërmjet grupeve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës gjatë këtij viti.

Më 11 shtator, grupe të shqiptarëve dhe serbëve u përleshën në Mitrovicë pas shkëmbimit të përqeshjeve dhe fyerjeve pas humbjes së Serbisë nga Turqia në gjysmëfinalen e kampionatit botëror në basketboll. Të dy palët gjuanin me gurë dhe përleshja përfundoi kur shqiptarët u

tërhoqën. EULEX-u iu përgjigj këtij incidenti dhe një prej njësive të tij sulmua me gurë, granata trullosëse, koktej Molotovi dhe armë zjarri nga serbët e Kosovës. Disa policë dhe protestues u lënduan në këtë incident, që mbeti nën hetime të PK-së.

Më 2 korrik, një protestë e organizuar nga strukturat paralele serbe kundër hapjes së qendrës për shërbim të qytetarëve në Mitrovicën veriore u bë e dhunshme, duke rezultuar në vdekjen e një boshnjaku të Kosovës, dr. Mesud Gjekoviq, dhe lëndimin e 11 të tjerëve. Vdekja dhe lëndimet ndodhën kur persona të paidentifikuar hodhën një granatë dore në masën e protestuesve serbë, të cilët marshonin drejt një shtëpie në lagjen etnikisht të përzier, Mëhalla e Boshnjakëve, në të cilën valonte një flamur shqiptar. Hetimet e EULEX-it dhe PK-së për këtë rast ishin në vazhdim e sipër.

Gjatë vitit 2009, policia e EULEX-it raportoi për 116 raste të krimeve të supozuara ndëretnike, në 86 raste serbët e Kosovës ishin të përfshirë si viktima ose të dyshuar. Nuk kishte të dhëna në dispozicion për vitin 2010. Hetimet për krime të tilla rezultuan në arrestimin e të dyshuarve në shumë raste.

Në qershor të vitit 2009, tre adoleshentë serbë gjoja u rrahën nga një grup i shqiptarëve të Kosovës në Lipjan gjersa kalonin nëpër një kantier ndërtimi. Më 16 qershor, policia ngriti padi për sulm kundër Atdhe Qerkinit, Kosovë Kelmendit, Bunjamin Jashanicës, Gëzim Xhemajlit, Gazmend Bletës, dhe Qëndrim Veselit. Më 17 qershor, Gjykata Komunale e Lipjanit urdhëroi që gjashtë të dyshuarit të mbaheshin në paraburgim në kohëzgjatje prej 30 ditësh, me përjashtim të Veselit, që ishte i mitur.

Nuk pati zhvillime në hetimet e policisë për gjashtë sulmet kundër romëve të kthyer që ndodhën në fshatin Abdullah Peseva në korrik dhe gusht të vitit 2009, apo të ngacmimit dhe kërcënimit të 20 familjeve rome, ashkalike dhe egjiptiane të lagjes Halit Ibishi në komunën e Ferizajt.

Nuk pati zhvillime në rastin e vitit 2008 në të cilin policia paditi Bllashko Lazar Simiqin, Tihomir Radivoje Millosheviqin, Miodrag Vlladimir Nikoliqin, dhe Bozho Zhivojin Stanojeviqin për sulm kundër një zyrtari publik dhe shkaktim të lëndimeve të lehta trupore gjatë një përleshjeje ndërmjet serbëve të Kosovës që protestonin lidhur me ndërtimin e një xhamie në fshatin Berivojcë, etnikisht të përzier, të komunës së Kamenicës. Dy policë dhe disa protestues u lënduan. Data e gjykimit mbeti pezull në fund të vitit.

Sipas një projekt-raporti të përgatitur nga Zyra e Kryeministrit për Çështje të Bashkësisë, punësimi i pakicave në institucione publike shënoi rënie gjatë këtij viti dhe në përgjithësi kufizohej në nivele më të ulëta të Qeverisë. Raporti rekomandoi që Qeveria të kontaktonte në mënyrë më aktive me anëtarë të pakicave dhe t‘i zbatonte mundësitë e barabarta për raportim, rekrutim, trajnim dhe procedurat gjuhësore.

Një studim i OSBE-së i vitit 2009 tregoi se përfaqësimi i pakicave në shërbimin civil ra prej 12 për qind në vitin 2006 në 9 për qind në vitin 2009 dhe mbeti posaçërisht i ulët në nivele të larta. Shkallët më të larta të punësimit të pakicave në sektorin publik janë në gjyqësi dhe polici.

Në arsim, ligji kërkon kushte të barabarta për nxënës, pavarësisht nga gjuha amtare, dhe parashikon të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave, deri në mbarim të shkollës së mesme. Megjithatë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

dhe organizatat ndërkombëtare raportuan që shkalla e regjistrimit në shkollë ishte më e ulët ndër bashkësitë pakicë jo-serbe (ashkalinj, boshnjakë egjiptianë, goranë, romë, turq, dhe të tjerë). Një studim i OSBE-së i vitit 2009 tregoi se shkalla e regjistrimit në shkollë për fëmijët serbë ishte 99 për qind dhe 96.5 për qind për fëmijët shqiptarë, kurse shkalla e regjistrimit në shkollë për bashkësitë jo-serbe arrinte mesatarisht në 76 për qind.

Fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë i vijonin mësimet në shkolla të përziera me fëmijët shqiptarë dhe serbë të Kosovës dhe thuhej se përballeshin me kërcënim dhe ngacmim në disa zona me shumicë shqiptare. Fëmijët romë ishin më të prapambetur për shkak të varfërisë, gjë që i shtyri shumë prej tyre të fillonin të punonin në shtëpi e në rrugë që në moshë të re për të kontribuar në të ardhurat e familjes.

Gjatë këtij viti pati raportime të herëpashershme që shqiptarët e Kosovës e shkatërronin pronën private që u takonte serbëve të Kosovës. Disa prej këtyre sulmeve mund të kenë qenë përpjekje për t'i detyruar serbët e Kosovës që ta shitnin pronën e tyre. Rregulloret ndalojnë shitjen me shumicë të pronës së bashkësive të serbëve të Kosovë në përpjekje për ta penguar kërcënimin e pronarëve të pronave të pakicave në zona të caktuara; megjithatë, këto rregullore rrallë zbatoheshin. Pati raportime të shumta që serbët e Kosovës kishin vështirësi për t'iu qasur pronës së tyre, që nganjëherë ishte e zënë ose shfrytëzohej nga shqiptarët e Kosovës. Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) raportoi se përballej me raste të shpeshta të zënies së paligjshme të pronës dhe me rizënie të pronave në veprimtaritë e saj të dëbimit, me shumë prona të vandalizuara apo të shkatërruara. P.sh., pati konflikte pronësore në fshatin Zallq të Istogut, ku qeveria është duke ndërtuar shtëpi për familjet serbe dhe malazeze të Kosovës që spontanisht u kthyen në maj në Kosovë nga Serbia dhe Mali i Zi. Këto prona, që janë në faza të ndryshme të ndërtimit, ishin vandalizuar në disa raste dhe tokës së pyllëzuar përreth pronave i ishte vënë zjarri. PK-ja arrestoi disa persona në lidhje me këto raste. Deri më tani, të gjithë të dyshuarit ishin të mitur, prej 7 – 14 vjeç.

Nuk pati zhvillime në rastin e vitit 2008, në të cilin OSBE-ja raportoi se një serb i Kosovës u përpoq ta vizitonte pronën e vet në Deçan me anëtarë të një ekipi të UNDP-së që planifikonte t'i ndihmonte në rindërtimin e shtëpisë së tij. Pronari serb nuk mund ta ushtronte të drejtën e tij për pronë, siç ishte vendosur nga AKP-ja, pasi shtëpia e tij ishe shkatërruar, dhe një familje shqiptare vazhdonte të jetonte në një shtëpi të re të ndërtuar në mënyrë të paligjshme në atë vend.

Nuk pati zhvillime në rastin e vitit 2008 në Klinë, në të cilin një serb i Kosovës raportoi se prona e tij ishte uzurpuar nga një shqiptar i Kosovës.

Në shtator, serbët e Kosovës në fshatin Malishevë u ankuan që planet për ndërtimin e një xhamie afër shtëpive të tyre krijuan një mjedis të papëlqyer për serbët, duke thënë që toka tjetër afër shtëpive të shqiptarëve të Kosovës ishte në dispozicion.

Abuzimet shoqërore, diskriminimi dhe aktet e dhunës të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e bazuar në orientim seksual; megjithatë, pati raportime për dhunë dhe diskriminim të lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, dhe të transgjinive (LHBT).

Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore (QZHGSH), një OJQ vendëse e përqendruar në çështjet shëndetësore të LHBT-ëve, raportoi se qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj homoseksualizmit i frikësonin shumicën e homoseksualëve dhe lezbikeve, kështu që ata e fshihnin orientimin e tyre seksual. LHBT-ët në përgjithësi ndjeheshin të pasigurt, shumë prej tyre raportonin kërcënime për sigurinë e tyre personale. Një studim i vitit 2008, i kryer nga Iniciativa rinore për të drejtat e njeriut, i financuar nga Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, gjeti që 57 për qind e LHBT-ëve të anketuar kishin frikë për sigurinë e tyre.

Mediat e shkruara nganjëherë i forconin qëndrimet negative duke botuar artikuj për homoseksualizmin, në të cilët LHBT-ët i përshkruanin si të sëmurë mendorë. Së paku një parti politike me orientim islam, Partia e Drejtësisë, përfshiu në platformën e vet politike dënimin e homoseksualizmit.

QZHGSH raportoi se, edhe pse kishte pak diskriminim zyrtar kundër LHBT-ëve, pati një sërë rastesh të diskriminimit shoqëror kundër LHBT-ëve gjatë këtij viti. Viktimat në përgjithësi nuk e lejonin qendrën që t'i paraqiste rastet e tyre publikisht për shkak të frikës nga diskriminimi. Nuk kishte pengesa të dukshme për punën e qendrës; megjithatë, presioni shoqëror dhe qëndrimet tradicionale ndikuan në kufizimin e veprimtarive të tyre. QZHGSH raportoi se Ministria e Punëve të Brendshme u vonua në sqarimin e përtëritjes së memorandumit të mirëkuptimit me PK-në për ngritjen e vetëdijesimit për çështjet e LHBT-ëve.

Nuk pati diskriminim zyrtar në punësim, strehim, në të qenët pa shtetësi, në qasje në shkollim apo kujdes shëndetësor; megjithatë, presioni shoqëror i detyroi pothuaj të gjithë LHBT-ët ta fshihnin orientimin e tyre seksual.

Dhuna apo diskriminimi tjetër shoqëror

Nuk pati raportime për diskriminim zyrtar të personave me HIV/AIDS gjatë këtij viti; megjithatë, pati raportime anekdotike se diskriminimi i tillë kishte ndodhur.

Seksioni 7 Të drejtat e punëtorëve

a. E drejta e asociimit

Rregulloret u lejojnë punëtorëve të formojnë dhe t'u bashkëngjiten sindikatave të pavarura që ata i zgjedhin, pa autorizim paraprak ose kërkesa të tepërta, por kjo e drejtë pengohej nganjëherë nga ndërmarrjet të cilat i kërcënonin punëtorët e vet kur ata u bashkoheshin apo formonin sindikata. Rregulloret nuk e njohin të drejtën për të bërë grevë; megjithatë, grevat në përgjithësi u lejuan në praktikë, dhe disa greva ndodhën gjatë këtij viti. Qeveria e miratoi Ligjin e ri për punë më 2 nëntor. Ligji përcakton që java e punës d t'i ketë 40 orë, parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për të punësuarit, dhe gjithashtu parashikon 12 muaj për pushim të lehonisë.

Sindikatat e vetme të rëndësishme ishin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe Konfederata e Sindikatave të Lira (KSL). Megjithatë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale raportoi se ndikimi i këtyre dy grupeve shënonte rënie pasi ish-anëtarët u përçanë për të formuar sindikata më të vogla.

b. E drejta për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht

Rregulloret e Qeverisë parashikojnë të drejtën për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht pa ndërhyrje apo kufizim, dhe Qeveria nuk e kufizoi këtë të drejtë në praktikë; megjithatë, asnjë negociim kolektiv nuk ndodhi gjatë këtij viti. Ligji u lejon sindikatave t'i udhëheqin veprimtaritë e veta pa ndërhyrje, dhe Qeveria e mbronte këtë të drejtë në praktikë.

Rregulloret ndalojnë diskriminimin antisindikal; megjithatë, disa zyrtarë të sindikatave raportuan për diskriminim në praktikë. BSPK dhe KSL raportuan se vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve i respektonte rregulloret që ndalonin diskriminimin antisindikal dhe pohonin se të drejtat e punëtorëve abuzoheshin në çdo sektor, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare, ku personeli nuk merrte pension.

Nuk ka zona përpunuese për eksport.

c. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Kodi penal e ndalon punën e dhunshme apo të detyruar, duke përfshirë punën e fëmijës; megjithatë, pati raportime që praktika të tilla ndodhën. Shih gjithashtu Raportin vjetor të Departamentit të Shtetit mbi Trafikimin e Personave në: www.state.gov/g/tip.

d. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punësim

Rregulloret e ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, duke përfshirë ndalimin e punës së dhunshme apo të detyruar; megjithatë, me përjashtim të trafikimit, Qeveria rrallë i kundërshtonte këto praktika. Trafikimi i fëmijëve, kryesisht për punë, ishte problem, ndonëse mungesa e të dhënave statistikore e vështirësoi llogaritjen e përmasës së trafikimit të fëmijëve. Shih gjithashtu Raportin vjetor të Departamentit të Shtetit mbi Trafikimin e Personave në: www.state.gov/g/tip.

Rregulloret e caktojnë moshën 16-vjeçare si moshë minimale për punësim dhe moshën 18-vjeçare si moshë minimale për cilëndo punë që mund ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve. Rregulloret u lejojnë fëmijëve të punojnë edhe në moshën 15-vjeçare, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta ndjekur shkollën. Ligji kërkon që fëmijët e moshës 6 dhe 15-vjeçare ta vijojnë shkollimin.

Puna e fëmijës mbeti problem. Sipas UNICEF-it, numri i fëmijëve që kërkonin lëmoshë në rrugët e qyteteve dhe qytezave shënoi rritje viteve të fundit, ndonëse numri i përgjithshëm i fëmijëve lypës mbeti i panjohur. Ndërsa shumica e fëmijëve nuk ishin fituesit kryesorë të të ardhurave të familjes, puna e fëmijës shërbente si ndihmë kryesore për shumë familje.

Në zonat rurale, fëmijët e rinj zakonisht u ndihmonin familjeve të veta në punë bujqësore. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh jozyrtare të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve dhe kartelave të telefonit në rrugë. Disa fëmijë gjithashtu merreshin me punë fizike, si transportimi i mallrave. OJQ-të ndërkombëtare, që ishin aktive në vend, vazhduan të raportonin për shkelje të rënda të rregulloreve të punës gjatë këtij viti, duke përfshirë punën e fëmijës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale koordinoi politikën e Qeverisë për mbrojtjen e fëmijëve, megjithatë, policia e kishte rolin kryesor për zbatimin e ligjeve mbi punën e fëmijës. Ministria raportoi se ishte bërë përparim i kufizuar në uljen e numrit të fëmijëve që

punonin në rrugë. Ministria dhe OJQ-të vendëse, me ndihmën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, punuan në identifikimin dhe largimin e fëmijëve nga rrugët. 691 fëmijë ishin identifikuar që nga viti 2007, 400 prej tyre iu kthyen shkollës.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Nuk ka ligj që përcakton rrogën minimale. Edhe pse jo i zbatueshëm si ligj, Qeveria, dhoma e tregtisë dhe bashkimi i sindikatave nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit në vitin 2004 me të cilin përcaktohej rroga minimale në 120 euro ($161) në muaj, që në përgjithësi respektohej, por nuk ofronte standard të kënaqshëm të jetesës për punëtorin dhe familjen. Rroga mesatare mujore në vend ishte 230 euro ($308) në sektorin publik dhe 280 euro ($375) në sektorin privat. Banka Botërore raportoi se, në bazë të statistikave të vitit 2007, 45 për qind e popullatës jetonte nën linjën kombëtare të varfërisë, dhe rreth 17 për qind ishin tejet të varfër, nuk ishin në gjendje t'i plotësonin nevojat themelore për ushqim. Rregulloret parashikojnë javën standarde të punës prej 40 orësh; kërkojnë kohën e pushimit; kufizojnë numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë; kufizojnë punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj; kërkojnë pagimin e bonusit për punën jashtë orarit; dhe ndalojnë punën e tepërt të detyrueshme jashtë orarit.

Gjatë këtij viti, punëdhënësit shpesh nuk i respektonin standardet zyrtare të punës për shkak të mungesës së detyrimit nga ana e Qeverisë, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. Punëtorët shpesh nuk i raportonin shkeljet e tilla për shkak të frikës nga reprezaljet. Sipas BSPK-së, shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat kinse sipas dëshirës së punëtorëve pa kontratë pune, pa pagesë të rregullt, apo kontribute pensionale të paguara në emër të tyre. Punëtorët raportonin se përjashtoheshin nga puna pa arsye dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi, dhe u mohoheshin festat. Organizatat për të drejtat e gruas treguan se ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte i paraportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo për hakmarrje fizike. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballeshin me keqtrajtim të ngjashëm, përfshirë këtu abuzimin seksual dhe humbjen e vendit të punës për shkak të lidhjes me parti politike.

Inspektorati i punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjës për zbatimin e standardeve të punës, shëndetit dhe sigurisë. Megjithatë, inspektorati kryesisht i këshillonte punëdhënësit, dhe ndonëse shqiptoi mbi 3,329 gjoba për inspektim në vend dhe 360 gjoba për shkelje të ndryshme të standardeve të punës gjatë pjesës së parë të këtij viti, ato mbetën pa u paguar në pritje të procesit gjyqësor.

Edhe pse ka ligj për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe të kushteve të tyre të punës, shumë institucione private e publike vazhduan ta shkelnin atë. Zyrtarët e inspektoratit të punës raportuan për vështirësi në marrjen e informatave të sakta pasi punëtorët rrallë i zbulonin problemet vetë, përkundër mbrojtjeve ligjore.